



COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2012. Ky përkthim u krye me mbështetje të Fondit të Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës (www.coe.int/humanrightstrustfund). Ai nuk është detyrues për Gjykatën. Për informacione të mëtejshme shiko të dhënat e plota për të drejtën e autorit në fund të këtij dokumenti.

© Council of Europe/European Court of Human Rights, 2012. This translation was commissioned with the support of the Human Rights Trust Fund of the Council of Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). It does not bind the Court. For further information see the full copyright indication at the end of this document.

© Conseil de l'Europe/Cour européenne des droits de l'homme, 2012. La présente traduction a été effectuée avec le soutien du Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme du Conseil de l'Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). Elle ne lie pas la Cour. Pour plus de renseignements veuillez lire l'indication de copyrights/droits d'auteur à la fin du présent document.

DHOMA E MADHE

ÇËSHTJA TAXQUET K. BELGJIKËS

(çështja nr. 926/05)

VENDIM

STRASBURG

16 nëntor 2010

Ky është vendim përfundimtar, por mund të jetë objekt redaktimi.

Në çështjen Taxquet k. Belgjikës,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në seancë si Dhomë e Madhe,
me trup gjykues të përbërë nga:

Jean-Paul Costa, *kryetar*,
Christos Rozakis,
Nicolas Bratza,
Peer Lorenzen,
Françoise Tulkens,
Josep Casadevall,
Boštjan M. Zupančič,
Nina Vajić,
Anatoly Kovler,
Elisabet Fura,
Sverre Erik Jebens,
Isabelle Berro-Lefèvre,
Päivi Hirvelä,
Luis López Guerra,
Mirjana Lazarova Trajkovska,
Nona Tsotsoria,
Zdravka Kalaydjieva, *gjyqtarë*,

dhe Michael O'Boyle, *Zëvendës Regjistrues*,

Pas shqyrtimeve me dyer të mbyllura më datë 21 tetor 2009 dhe 26 maj
dhe 6 tetor 2010,

Jep vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit të
përmendur më lart:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në një kërkesë (nr. 926/05) kundër Mbretërisë së Belgjikës, të depozituar në Gjykatë sipas Nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (më poshtë “Konventa”) nga një nënshtetas belg, Z. Richard Taxquet (“ankimuesi”), më 14 dhjetor 2004.

2. Kërkuesi u përfaqësua nga Z. Misson dhe Mr J. Pierre, avokatë që e ushtrojnë profesionin në Liège, Belgjikë. Qeveria belge (“më poshtë Qeveria”) u përfaqësua nga agjentët e saj, Z M. Tysebaert, Këshilltar i Lartë, nga Departamenti i Drejtësisë Federale, dhe Z. A. Hoefmans.

3. Kërkuesi pretendonte veçanërisht shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës për mungesë arsytimi në vendimin e Gjykatës për Krime të Rënda në çështjen e tij dhe pamundësinë e pyetjes ose marrjes në pyetje të një dëshmitari anonim.

4. Çështja iu dërgua Seksionit të Dytë të Gjykatës (Rregulli 52 § 1 i Rregullores së Gjykatës), i përbërë prej: Ireneu Cabral Barreto, Françoise Tulkens, Vladimiro Zagrebelsky, Danutė Jočienė, Dragoljub Popović, András Sajó dhe Işıl Karakaş, gjyqtarë, si dhe nga Sally Dollé, Sekretare e Seksionit. Më 13 janar 2009 Dhoma dha një vendim, sipas të cilit u vendos me unanimitet që ankesat e ngritura në bazë të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të shpallen të pranueshme dhe u konstatuan shkelje të të dy dispozitave.

5. Më datë 5 qershor 2009, pas një kërkesë të Qeverisë, datë 8 prill 2009, paneli i Dhomës së Madhe vendosi t'ia caktojë çështjen Dhomës së Madhe sipas nenit 43 të Konventës.

6. Përbërja e Dhomës së Madhe u përcaktua në përputhje me dispozitat e nenit 27 §§ 2 dhe 3 të Konventës dhe të Rregullit 24.

7. Si kërkuesi dhe Qeveria bënë komente me shkrim. Po ashtu, u morën komente nga palët e treta nga Qeveria e Mbretërisë së Madhe, Qeveria e Irlandës dhe nga Qeveria e Francës, të cilave u ishte lejuar nga Presidenti që të ndërhyjnë me anë të procedurës me shkrim (neni 36 § 2 i Konventës dhe Rregulli 44 § 2).

8. U organizua një seancë dëgjimore me dyer të hapura në Ndërtesën e të Drejtave të Njeriut, në Strasburg, më 21 tetor 2009 (Rregulli 59 § 3).

Para Gjykatës u paraqitën si më poshtë:

(a) *për Qeverinë*

Z. A. HOEFMANS,

Agjent,

Z. K. LEMMENS,

avokat;

(b) *për ankimuesin*

Z. L. MISSON,

Z. J. PIERRE, *avokat,*

Z. R. TAXQUET,

kërkuës.

Gjykata dëgjoi me vëmendje fjalët e Z. Misson, Z. Pierre dhe të Z. Lemmens dhe përgjigjet që ata dhanë për pyetjet e bëra nga anëtarët e Gjykatës.

FAKTET E ÇËSHTJES

I. Rrethanat e Çështjes

9. Kërkuesi ka lindur në vitin 1957 dhe jeton në Angleur.

10. Më 17 tetor 2003 kërkuesi u paraqit para Gjykatës së Krimeve të Rënda në Liège, së bashku me shtatë të pandehur të tjerë, në një proces me akuzën e vrasjes së një ministri nderi (*ministre d'Etat*), A.C., dhe të tentativës për vrasje të partneres së të ndjerit, M.-H.J. Sipas formulimit të aktakuzës, ata akuzoheshin për veprat e mëposhtme të kryera në Liège më 18 korrik 1991:

“si autor ose si bashkautor krimi,

ose për kryerjen e veprave penale ose për bashkëpunim të drejtpërdrejtë në kryerjen e tyre,

ose për dhënien, me anë të çdo mjeti, të ndihmës për kryerjen e këtyre veprave, pa praninë e së cilës veprat nuk do të mund të ishin kryer,

ose për nxitjen e drejtpërdrejtë të dikujt tjetër për kryerjen e këtyre veprave nëpërmjet dhuratave, premtimeve, abuzimit me detyrën, kompleteve ose intrigave,

ose për nxitjen e drejtpërdrejtë, nëpërmjet fjalimeve në një vend publik, ose me anë të materialeve të shkruara ose të shtypura, me anë të një imazhi ose embleme, të shpërndarë ose të shitur, ofrimit për shitje ose ekspozimit nga ku mund të shikohet nga publiku, të dikujt tjetër për kryerjen e këtyre veprave.

1. për vrasjen me dijeni dhe qëllimisht [A.C.], me rrethanën shtesë që vrasja është kryer me paramendim, vepër e parashikuar nga ligji si vrasje me paramendim (*assassinat*);

2. për tentativën për vrasje, me dijeni, qëllimisht dhe me paramendim, të [M.-H.J.], ku qëllimi për kryerjen e veprës është manifestuar nëpërmjet sjelljes që përbën shprehimisht hapin e parë drejt përgatitjes për veprën, e cila u ndalua ose dështoi të arrijë qëllimin vetëm për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të autorëve të veprës, vepër kjo e klasifikuar nga ligji si vrasje me paramendim.”

11. Vetëm njëri nga të pandehurit e tjerë depozitoi një deklaratë mbrojtjeje. Kërkuesi pretendoi se për të ishte e pamundur ta bënte këtë gjë për shkak se nuk ishte në dijeni të provës kundër tij.

12. Aktpadia e datës 12 gusht 2003 deklaronte, *inter alia*, se në qershor të vitit 1996, një person i përshkruar si dëshmitar anonim i kishte kaluar disa informacione hetuesve. Një shënim i datës 3 shtator 1996 vërente se ishte dëshira e informatorit që ai të mbetej anonim nga frika për pasigurinë e jetës “për shkak të rëndësisë së informacionit të dhënë prej tij dhe interesit të medias, e cila e kishte mbuluar gjithmonë çështjen C.”. Personi në fjalë nuk ishte intervistuar kurrë nga një gjyqtar hetimi. Ai u kishte dhënë hetuesve informacionin e marrë në konfidencë nga një person, emrin e të cilit ai refuzoi ta bënte të ditur. Gjatë procesit të gjykimit në Gjykatën e

Krimeve të Rënda, hetuesve iu bë pyetja lidhur me iniciativën e shumë prej të pandehurve për identitetin e informuesit. Hetuesit u shprehën që personi që u kishte dhënë informacionin nuk ishte njëri prej të pandehurve dhe se ai nuk kishte qenë dëshmitar okular në veprat e kryera. Mbi bazën e informacionit të dhënë, i cili u parashtrua në pesëmbëdhjetë pika, vrasja e A.C.-së ishte planifikuar nga gjashtë njerëz, duke përfshirë kërkuesin dhe një tjetër politikan të rëndësishëm. Pjesa që inkriminonte kërkuesin kishte këtë formulim:

“V. der B. dhe Taxquet thuhet të kenë qenë shumë këmbëngulës për nevojën urgjente për të vrarë C. përpara pushimeve të ‘91-it, pasi ky i fundit kishte premtuar se do të bënte me dije disa informacione shumë të rëndësishme pas pushimeve të verës.”

13. Për shkak të padive të shumta të ngritura gjatë procesit, Gjykata e Krimeve të Rënda lëshoi trembëdhjetë vendime të përkohshme deri në pritje të shqyrtimit të themelit të çështjes:

(1) vendimin, datë 17 tetor 2003, ku vërehej mungesa e disa të pandehurve në procesin gjyqësor dhe njoftimi se ata do të gjykoreshin në mungesë (*in absentia*);

(2) vendimin, datë 20 tetor 2003, për deklarimin të pavlefshëm të kërkesës për përballje ndërmjet dëshmitarëve;

(3) vendimin, datë 27 tetor 2003, në lidhje me shqyrtimin e dëshmitarëve pa praninë e njërit nga të pandehurit e tjerë;

(4) vendimin, datë 3 nëntor 2003, për marrjen në pyetje të një dëshmitari në sallën e gjyqit;

(5) Vendimin, datë 6 nëntor 2003, për lënien mënjane të një urdhri gjykimi në mungesë (*in absentia*) për një ndër të pandehurit;

(6) vendimin, datë 13 nëntor 2003, i cili e refuzon kërkesën e akuzës për seancë dëgjimore me dyer të mbyllura;

(7) vendimin, datë 19 nëntor 2003, për marrjen në pyetje të disa dëshmitarëve në seancë me dyer të mbyllura;

(8) vendimin, datë 18 dhjetor 2003, për kërkesën e një të pandehuri tjetër për marrjen në pyetje të disa dëshmitarëve;

(9) vendimin, datë 18 dhjetor 2003, për përdorimin e regjistrimeve të një konfrontimi ndërmjet dëshmitarëve;

(10) vendimin, datë 18 dhjetor 2003, për një kërkesë nga palët civile për marrjen në pyetje të dëshmitarëve që nuk ishin paraqitur dhe ri-marrjen në pyetje të dëshmitarëve të tjerë;

(11) vendimin, datë 18 dhjetor 2003, për kërkesën e një të pandehuri tjetër për marrjen në pyetje dhe ri-marrjen në pyetje të dëshmitarit anonim;

(12) vendimin, datë 18 dhjetor 2003, lidhur me komentet e kërkuesit për marrjen në pyetje të dëshmitarëve që cilët nuk ishin paraqitur dhe rimarrjen në pyetje të dëshmitarëve të tjerë;

(13) vendimin, datë 18 dhjetor 2003, për kërkesën e kërkuesit për marrjen ose rimarrjen në pyetje të dëshmitarit anonim.

14. Në vendimin e fundit, në lidhje me kërkesën që një gjyqtar hetues të dëgjojë ose të ri-dëgjojë provat e dhëna nga një person që ka dhënë informacion në kushtet e ruajtjes së anonimatit, të regjistruar nga dy oficerë xhandarmërie, Gjykata e Krimeve të Rënda u shpreh:

“Ky informacion, i marrë në mënyrë anonime nga anëtarë të forcave të policisë, nuk ka vlerë prove si i tillë. Për pasojë, në çështjen në fjalë, ai thjesht përbën informacion që është në gjendje për t’i dhënë një shtysë të freskët ose një kthesë të re hetimeve, dhe për të bërë të mundur mbledhjen e pavarur të provave të ligjshme.

Kur u morën në pyetje si dëshmitarë në procesin gjyqësor [të dy oficerët e xhandarmërisë] deklaruan se informatori i tyre nuk ishte njëri prej të pandehurve dhe se ai (informatori) nuk kishte qenë dëshmitar okular në ndonjërin nga aktet e përshkruara; ai mezi e kishte dhënë informacionin që pretendon se e ka marrë në mirëbesim nga një person, identitetin e të cilit nuk pranon ta bëjë të ditur.

Oficerët e xhandarmërisë bënë me dije po ashtu se një pjesë e informacionit që u ishte dhënë nga informatori i tyre, i lidhur posaçërisht me politikanët e tjerë të përmendur në komentet e avokatit të Richard Taxquet ..., nuk mund të mbështetej me prova, pavarësisht nga hetimet e tyre.

...

Në mendimin e hetuesve, procesi i shkrimit të një raporti zyrtar me informacion të dhënë nga një informator anonim në vetvete nuk përbën cenim të të drejtave të mbrojtjes për personat e përmendur nga informatori. Ky hap përfshin thjesht dhënie e informacionit, me synim analizimin dhe verifikimin e të dhënave që mund të jenë me interes për hetimin dhe mund të ndihmojnë në qartësimin e fakteve. I parë në izolim nga të dhëna të tjera objektive që mund ta konfirmojnë këtë informacion më pas, informacioni nuk përbën prova të akteve që pretendohet të jenë kryer nga personat identiteti i të cilëve përmendet nga informatori.

...

Së fundmi ... nuk është e mundur të flitet për një ekzaminim, duke parë që ai nuk rezulton nga dosja e çështjes, ose nga proceset gjyqësore verbale që [nga personi i përshkruar si dëshmitar anonim] japin prova nën betim para një gjyqtari hetues.

Në lidhje me kërkesën për marrjen në pyetje të këtij personi, së pari, Gjykata nuk është në dijeni të identitetit të tij dhe, së dyti, pavarësisht nga komentet e bëra nga organet e hetimeve gjyqësore për këtë pikë, ky ekzaminim nuk rezulton i dobishëm për përcaktimin e së vërtetës dhe do të çonte në vonesa të panevojshme të proceseve pa dhënë shkaqe për shpresa për rezultate më të sigurta.”

15. Trupit gjykues të përbërë nga gjyqtarë jo profesionistë iu kërkua t’i përgjigjej tridhjetë e dy pyetjeve, të cilat u bënë nga Kryetari i Gjykatës së Krimeve të Rënda. Katër prej këtyre pyetjeve lidheshin me kërkuesin dhe u formuluan si më poshtë:

“Pyetja 25 – akuza për autorin e krimit

A është i akuzuari Richard Taxquet, i pranishëm në gjykatë, fajtor,
si autor ose bashkautor në krim,

ose për kryerjen e veprave penale ose për bashkëpunim të drejtpërdrejtë në kryerjen e tyre,

ose për dhënien, me anë të çdo mjeti, të ndihmës për kryerjen e këtyre veprave, pa të cilën veprat nuk do të mund të ishin kryer,

ose për nxitjen e drejtpërdrejtë të dikujt tjetër për kryerjen e këtyre veprave nëpërmjet dhuratave, premtimeve, abuzimit me detyrën, kompleteve ose intrigave,

ose për nxitjen e drejtpërdrejtë, nëpërmjet fjalimeve në një vend publik, ose me anë të materialeve të shkruara ose të shtypura, me anë të një imazhi ose embleme, të shpërndarë ose të shitur, ofrimit për shitje ose ekspozimit nga ku mund të shikohet nga publiku, të dikujt tjetër për kryerjen e këtyre veprave.

Për vrasjen me dijeni dhe qëllimisht të [A.C.] në Liège më 18 korrik 1991?

Pyetja 26 – RRETHANAT RËNDUESE

A ka qenë e paramenduar vrasja të cilës i referohet pyetja e mëparshme?

Pyetja 27 – akuza për autorin e krimi

A është i akuzuari Richard Taxquet, i pranishëm në gjykatë, fajtor,

si autor ose bashkautor në krim,

ose për kryerjen e veprave penale ose për bashkëpunim të drejtpërdrejtë në kryerjen e tyre,

ose për dhënien, me anë të çdo mjeti, të ndihmës për kryerjen e këtyre veprave, pa praninë e së cilës veprat nuk do të mund të ishin kryer,

ose për nxitjen e drejtpërdrejtë të dikujt tjetër për kryerjen e këtyre veprave nëpërmjet dhuratave, premtimeve, abuzimit me detyrën, kompleteve ose intrigave,

ose për nxitjen e drejtpërdrejtë, nëpërmjet fjalimeve në një vend publik, ose me anë të materialeve të shkruara ose të shtypura, me anë të një imazhi ose embleme, të shpërndarë ose të shitur, ofrimit për shitje ose ekspozimit nga ku mund të shikohet nga publiku, të dikujt tjetër për kryerjen e këtyre veprave.

për tentativë për vrasje me dijeni dhe me paramendim ndaj [M.-H.J.] në Liège më 18 korrik 1991, ku synimi i kryerjes së veprës është manifestuar nëpërmjet sjelljes, e cila në mënyrë objektive ka përbërë hapin e parë drejt realizimit të veprës që u ndalua ose nuk ia arriti të përmbushte qëllimin përfundimtar për rrethana jashtë kontrollit të keqbërësit?

Pyetja 28 – RRETHANA RËNDUESE

A ishte e paramenduar tentativa për vrasje e përmendur në pyetjen e mëparshme?"

16. Trupi gjykues iu përgjigj "po" të gjitha pyetjeve.

17. Më 7 janar 2004, Gjykata e Krimeve të Rënda e dënoi kërkuesin me njëzet vjet heqje lirie.

18. Kërkuesi apeloj për bazën ligjore ku mbështetet dënimi i tij dhënë nëpërmjet vendimit datë 7 janar 2004 nga Gjykata e Krimeve të Rënda dhe për të gjitha vendimet e ndërmjetme të dhëna nga e njëjta gjykatë.

19. Në një vendim, datë 16 qershor 2004, Gjykata e Kasacionit e rrëzoi kërkesën e kërkuesit. Ajo u shpreh veçanërisht se:

– prania e vonuar e një të pandehuri tjetër nuk mund të cenojë të drejtat e mbrojtjes së apeluesve, pasi këta të fundit kanë qenë në gjendje që t'i

përgjigjen lirisht si deklaratave të bëra nga ky i pandehur gjatë fazës së hetimit paraprak, të dhëna në procesin gjyqësor nga personat që u ishin dhënë këto deklarate, si dhe deklaratave të bëra në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vetë i pandehur para trupit gjykues;

- Gjykata e Krimeve të Rënda ka urdhëruar me të drejtë marrjen në pyetje të dy dëshmitarëve me dyer të mbyllura, nga frika se ata mund të mos ishin në gjendje të shpreheshin lirshëm nëse seancat gjyqësore do të ishin të hapura, gjë e cila, nga ana e saj, do të pengonte administrimin e duhur të drejtësisë;

- në refuzimin e shfaqjes së një regjistrimi që përqendrohet në konfrontimet ndërmjet disa prej të pandehurve dhe disa nënshtetasve tunizianë, kundër të cilëve është ngritur padi, me arsyetimin se ky hap mund të vonojë pa fund proceset gjyqësore, Gjykata e Krimeve të Rënda nuk i ka cenuar të drejtat për mbrojtje apo parimin e realizimit të proceseve gjyqësore me gojë, për shkak se refuzimi është bazuar në faktin që pjesëmarrësit në konfrontim, për shkak se janë paraqitur në procesin gjyqësor, janë konfrontuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me të pandehurit;

- në konstatimin që procesi gjyqësor duhet të vazhdojë me arsyetimin se marrja në pyetje e disa dëshmitarëve të caktuar që nuk ishin paraqitur në gjykatë (por që ishin marrë në pyetje në mënyrën e duhur) nuk ishte e nevojshme për përcaktimin e së vërtetës, dhe në vendimin që paraqitja e mëtejshme e disa dëshmitarëve të caktuar “do të kishte të ngjarë të zgjaste procesin gjyqësor pa fund, duke mos dhënë shkak për shpresë për më shumë rezultate”, Gjykata e Krimeve të Rënda nuk e ka shkelur nenin 6 të Konventës dhe as parimin e realizimit me gojë të proceseve gjyqësore;

- për shkak se prezumimi i pafajësisë, i lidhur mbi të gjitha me sjelljen e gjyqtarëve që përcaktojnë një vepër penale, komentet e një hetuesi dhe raportet në shtyp, edhe në rast kur ato nuk janë të sakta, keqdashëse ose që çojnë në një vepër penale, në vetvete nuk mund t'i shkaktojnë procesit gjyqësor shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 2 e Konventës;

- nuk mund të pretendohet se nga mungesa e pretenduar e eksperiencës së anëtarëve të trupit gjykues, nga shpejtësia e gjykimit, ose nga mungesa e arsyeve të dhëna në vendimin e tyre, trupi gjykues ka qenë i pamundur të realizojë një gjykim të paanshëm për një çështje që ka tërhequr një vëmendje të madhe të shtypit;

- procedura për caktimin e anëtarëve të trupit gjykues dhe fakti që ata arritën të merrnin vendimin e fajësisë pa e diskutuar çështjen me gjykatën nuk do të thotë që Gjykata e Krimeve të Rënda nuk është Gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj brenda kuptimit të Nenit 6 § 1 të Konventës, ose që prezumimi i pafajësisë së të akuzuarit nuk mund të rrëzohet në mënyrë të ligjshme në këtë Gjykatë;

- as neni 6 dhe as neni 13 i Konventës nuk e garantojnë të drejtën e apelit;

– as neni 6 §§ 1 dhe as neni 3 (b) i Konventës, as neni 14 § 3 (b) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe as neni 149 i Kushtetutës, edhe në rast se lexohen në lidhje me dispozitat e sipërpërmendura të Traktatit, nuk i vendosin ndonjë detyrim trupit gjykues që të japë shpjegime për përgjigjet e pyetjeve që i bëhen atij;

– shkaqet e apelit të lidhura me nenin 6 § 3 (b) të Konventës (pamundësia për t'u shprehur lirshëm me avokatin e tij për shkak të ndalimit ditën përpara fillimit të procesit) u shpallën si të papranueshme pasi nuk rezultonte nga provat në dosjen e ankimuesit që ky i fundit kishte pretenduar shkeljen e të drejtës për ambient të përshtatshëm për përgatitjen e mbrojtjes para Gjykatës së Krimeve të Rënda;

– Neni 10 dhe 11 i Kushtetutës, neni 14 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile dhe neni 6 § 1 i Konventës nuk parashikojnë kërkesën për dhënie arsyes për një vendim fajësie, ose për të drejtën e apelimit, ose për të drejtën për të dalë përpara gjykatave të përbëra vetëm nga gjyqtarë profesionistë; për më tepër, diskrecioni i një gjykate të përbërë nga persona të thjeshtë (të cilat quhen ndryshe *lay jury*, ose gjykata popullore), i parashikuar në nenet 351, 352, 364 dhe 364 *bis* të Kodit të Procedurës Penale, nuk ngre çështjen e një difference arbitrare në trajtim për qëllimet e nenit 14 të Konventës ndërmjet atyre që gjykohen nga gjykata të tilla dhe atyre që gjykohen nga gjykata të tjera penale.

20. Në lidhje me shkaqet e apelit ku pretendohet se apeluesi ka bindjen se vendimi kundër tij është marrë kryesisht ose aksidentalisht bazuar në deklaratat e informatorit anonim, Gjykata e Kasacionit shprehet:

“Për aq kohë sa kërkuesi atakon komentin e Gjykatës së Krimeve të Rënda lidhur me faktin që ajo nuk ishte në dijeni për identitetin e personit për të cilin kërkohet marrja në pyetje, dhe për shkak se gjykata nuk mund ta urdhëronte marrjen e tij në pyetje, këto shkaqe apelimi, për shkak se drejtohen kundër një *obiter dictum*, nuk janë materiale.

Për këtë arsye, shkaqet e apelit janë të papranueshme.

Në lidhje me pjesën tjetër të argumenteve, prania në dosjen penale e një raporti që përmban informacion nga një burim i paidentifikuar nuk i kërkon gjykatës të sigurohet për identifikimin e informatorit dhe as të merret me marrjen e tij në pyetje në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 189 *bis* dhe në nenin 315 *bis* të Kodit të Procedurës Penale si kusht për vlefshmërinë ose pranueshmërinë e ndjekjes. Këto dispozita e lënë të hapur për gjykatën që e shqyrton çështjen të caktojë një gjyqtar hetues për këtë qëllim, në rast se ky hap duket i dobishëm për përcaktimin e së vërtetës.

Vendimet marrin qasjen që, mbi bazën e vlerësimit faktik për të cilin kjo gjykatë nuk ka kompetencë kundërshtimi, marrja në pyetje e kërkuar nga apeluesi do ta vononte pafundësisht procesin gjyqësor në mënyrë të panevojshme, pa pasur ndonjë shkak për shpresë për rezultate të caktuara.

Vendimet vërejnë gjithashtu se informacioni i marrë në mënyrë anonime nuk përkon me përkufizimin e provave të marra në mënyrë të ligjshme dhe në mënyrë të pavarur kundër të pandehurve.

Nuk rezulton nga përgjigja e Gjykatës së Krimeve të Rënda për komentet e apellesve se procesi gjyqësor i ka kontestuar të drejtat e tyre për të kundërshtuar provat e parashtruara gjatë procesit gjyqësor.

Për këtë arsye, këto shkaqe apeli nuk janë të lejueshme.

Në lidhje me argumentin tjetër që mbetet, lidhur me nenin 6 § 3 (d) të Konventës ... ky nen nuk është shkelur nga vetë fakti i thjeshtë që gjykata e ka konsideruar atë të panevojshëm, ose të pamundur për të urdhëruar marrjen në pyetjet të informatorit anonim, informacionet e të cilit kanë dhënë udhëzim të dobishëm për hetimet në proces.

Për këtë arsye, këto shkaqe apelimi nuk janë të mbështetura në ligj.”

21. Në programin *Questions à la Une* të transmetuar nga Radio-Télévision Belge Francophone (transmetuesi shtetëror për pjesën frankofone të Belgjikës) në fillim të vitit 2006, një ndër të pandehurit e tjerë në procesin e apeluar nga kërkuesi, me inicialet S.N., tha se informatori anonim ishte vetë ai dhe se ai kishte luajtur rolin e “ndërmjetësit” në emër të një të pandehuri tjetër, D.C.. Gjatë të njëjtit program, Ministria e Drejtësisë kishte konfirmuar identitetin e dëshmitarit anonim në kohën e ngjarjeve. S.N. deklaroi se kishte marrë shumën e 3,000,000 frangave belge (BEF – 74,368.06 euro (EUR)) nga shteti belg si “komision ndërmjetësimi”. D.C. pretendohet të kishte marrë BEF 5,000,000 (EUR 123,946.76).

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM DHE PRAKTIKA GJYQËSORE

A. Institucioni i trupit gjykues dhe Gjykata e Krimeve të Rënda

22. Pas Revolucionit Francez të vitit 1789, në Kushtetutën franceze të vitit 1791 dhe në Kodin e Procedurës Penale të vitit 1808 shfaqet termi juri (*jury*) ose trup gjykues. Në atë njëjtën kohë, Belgjika ishte pjesë e territorit francez. Kur Belgjika u nda nga Franca dhe u bashkua me Holandën, koncepti i jurisë (trupit gjykues) u hoq, por gjykatat e Krimeve të Rënda vijuan të ekzistojnë. Në kohën kur Belgjika fitoi pavarësinë, institucioni i jurisë (trupit gjykues) u mishërua në Kushtetutën e datës 7 shkurt 1831, neni 98 i së cilës parashikonte: “Trupi gjykues do të krijohet për të gjitha krimet e rënda dhe për veprat politike dhe të shtypit.” Institucioni parashikohej nga hartuesit e Kushtetutës si guri i themelit të autenticitetit të çdo kërkesë demokratike. Trupi gjykues konsiderohej mbi të gjitha si afirmim politik i lirisë së fituar nga njerëzit dhe si simbol i sovranitetit të njerëzve. Ai u përcaktuar me anë të Dekretit datë 19 korrik 1831; anëtarësimi në trupin gjykues fillimisht bazohej në funksionin e tij (*jury capacitaire*) dhe më pas, që prej vitit 1869, në pronësinë (*jury censitaire*). Sipas parashikimit të një ligji, datë 21 dhjetor 1930, një reformë e re e bëri përbërjen e trupit gjykues më demokratike, duke siguruar përfaqësinë e të gjitha klasave shoqërore. Pra, bëhet fjalë për trupin gjykues të përbërë prej dymbëdhjetë anëtarësh të

cilët janë gjyqtarë jo profesionistë, i cili ekziston dhe sot e kësaj dite në Belgjikë.

B. Kushtetuta

23. Neni 150 i Kushtetutës së Konsoliduar të 17 shkurtit 1994 parashikon që: “Trupi gjykues do të krijohet për të gjitha krimet e rënda dhe për veprat politike dhe ato të lidhura me shtypin, në përjashtim të veprave të shtypit të motivuara nga racizmi dhe ksenofobia” (teksti i ndryshuar më 7 maj 1999).

24. Për më tepër, neni 149 parashikon që: “të gjitha vendimet duhet të jenë të arsyetuara. Ato duhet të shpallen në publik.”

C. Procedura në Gjykatën e Krimeve të Rënda

1. Garancitë që ofrohen nga Kodi i Procedurës Penale (në fuqi në kohën materiale)

25. Proceset gjyqësore në gjykatat e krimeve të rënda në Belgjikë ofrojnë disa garanci, në veçanti lidhur me të drejtat e mbrojtjes së të akuzuarit.

26. Neni 241 i Kodit të Procedurës Penale (CCP) i kërkon Prokurorit Publik të përpilojë një aktakuzë duke dhënë natyrën e veprës që përbën bazën e akuzës, si dhe çdo rrethanë që mund të shkaktojë ngritjen ose uljen e dënimit. Në përputhje me nenin 313 të KPP-së, Kryeprokurori Publik duhet ta lexojë aktakuzën dhe i pandehuri ose avokati i tij duhet të japin deklaratën e tyre të mbrojtjes. Neni 337 parashikon që pyetjet që i drejtohen trupit gjykues duhet të rrjedhin nga aktakuza (e cila në vetvete duhet të jetë në përputhje me vendimin për hapjen e procesit gjyqësor për të akuzuarin – neni 271 i KPP-së) dhe duhet të jenë në përputhje me disa kërkesa formale, si për shembull, pyetjet komplekse ose që lidhen me ligjshmërinë e procesit janë të ndaluara.

27. Në përfundim të proceseve me gojë, trupit gjykues i bëhen pyetje për të përcaktuar rrethanat faktike të çështjes, si dhe çdo faktor të posaçëm që ka të ngjarë të çojë në përcaktimin e saktë nëse i akuzuari është ose jo fajtor për akuzën e ngritur kundër tij. Kryetari i Gjykatës së Krimeve të Rënda inkurajohet t’i bëjë pyetje trupit gjykues për rrethanat që mund të kenë ndikim mbi faktet që kanë shërbyer si bazë për padinë, me kusht që këto rrethana të jenë shqyrtuar gjatë proceseve me gojë. Pyetja kryesore lidhet me elementët përbërës të veprës, ndërkohë që duhet të ketë një pyetje të veçantë për secilën akuzë. Mund të bëhen dhe pyetje të veçanta lidhur me fakte të tjera, të tilla si rrethanat rënduese ose prania e çdo faktori justifikues ose lehtësues. Prokuroria dhe i akuzuari mund ta kundërshtojnë pyetjen dhe kanë mundësi t’i kërkojnë kryetarit t’i bëjë një ose më shumë pyetje të tjera

shtesë trupit gjykues. Në rast mosmarrëveshje lidhur me pyetjet, Gjykata e Krimeve të Rënda duhet të vendosë me anë të një gjykimi të arsyetuar.

28. Neni 341 parashikon që pas bërjes së pyetjeve, Kryetari ia jep ato (pyetjet) trupit gjykues; në të njëjtën kohë ai dorëzon aktakuzën, raportet që përcaktojnë veprën penale dhe dokumentet e tjera në dosje përveç deklaratave me shkrim të dëshmitarit.

29. Në përputhje me nenin 342, pasi janë drejtuar pyetjet dhe pasi ato i janë dhënë anëtarëve të trupit gjykues, trupa gjykuese tërhiqet për shqyrtim të çështjes privatisht. Kryesuesi i trupit gjykues është ose anëtari i parë i trupit gjykues i zgjedhur me short, ose caktohet nga trupi gjykues me pëlqimin e tij ose të saj. Përpara fillimit të procesit, kryesuesi i trupit gjykues lexon udhëzimin e mposhtëm, i cili është po ashtu i shtypur me germa të mëdha në vendin më të dukshëm të sallës ku zhvillohet procesi: “Ligji nuk u kërkon gjyqtarëve të japin llogari për mënyrën sesi ata e kanë arritur bindjen e tyre personale; ai nuk parashikon rregulla të cilave ata duhet t’u kushtojnë më shumë rëndësi lidhur me plotësueshmërinë dhe mjaftueshmërinë e provave; ai u kërkon atyre (gjyqtarëve) t’i bëjnë pyetje vetes, në heshtje dhe duke menduar thellë, dhe të vlerësojë, në sinqeritetin e ndërgjegjes së tyre, se çfarë përshtypje është lënë në mendjet e tyre nga provat kundër të pandehurit dhe nga parashtrimet e mbrojtjes. Ligji nuk u thotë atyre: ‘Ju duhet që çdo fakt ta verifikoni me anë të një numri x të dëshmimeve të vërteta’; dhe as nuk ju thotë: ‘nuk do ta konsideroni si mjaftueshmërisht të përcaktuar çdo provë që nuk rrjedh nga ky raport, këto dëshmi, nga ky numër dëshmitarësh ose nga kaq hamendësime; ligji thjeshtë u kërkon atyre t’i përgjigjen një pyetje, e cila përfshin objektin e plotë të detyrave të tyre: ‘a jeni të bindur brenda vetvetes?’”

30. Neni 343 i autorizon anëtarët e trupit gjykues të largohen nga dhoma e shqyrtimeve vetëm pasi të kenë marrë vendimin.

31. Së fundmi, neni 352 parashikon që në rast se gjyqtarët janë në mënyrë unanime të bindur që gjyqtarët e tjerë të trupit gjykues që nuk janë pjesë e gjyqtarëve profesionistë kanë bërë një gabim substantiv, ndërkohë që i kanë respektuar kërkesat procedurale, gjykata duhet ta pezullojë procesin dhe ta shtyjë atë deri për në seancën tjetër për shqyrtim nga një trup tjetër gjykues, i cili nuk mund të përfshijë asnjërin nga anëtarët e mëparshëm të trupit gjykues. Gjithsesi, mbi bazën e informacionit të dhënë nga Qeveria, ky opsion është përdorur vetëm në tri raste.

2. Jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit

32. Vendimi i Dhomës, datë 13 janar 2009, ka pasur ndikim mbi jurisprudencën e gjykatave belge.

33. Në vendimin nr. 2505 (P.09.0547.F), datë 10 qershor 2009, Gjykata e Kasacionit u shpreh:

“Në lidhje me shkaqet e apelit, të ngritura *proprio motu*, që pretendojnë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për Mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut:

Mbi bazën e vendimit datë 13 janar 2009 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në çështjen *R.T. k. Mbretërisë së Belgjikës*, e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës, nënkupton që në rastet kur bëhet fjalë për Gjykatat e Krimeve të Rënda, vendimi për një akuzë penale duhet të theksojë konstatimet që e kanë bindur trupin gjykues për fajësinë e të akuzuarit, ose për pafajësinë e tij, dhe duhet të japë arsyet e sakta pse secila nga pyetjet ka marrë një përgjigje afirmuese ose negative.

Në lidhje me efektin detyrues të interpretimit që i bashkëlidhet tani këtij vendimi dhe me epërsinë e të drejtës ndërkombëtare mbi legjislacionin e brendshëm, gjë e cila rrjedh nga një trakt i ratifikuar nga Belgjika, Gjykata është e detyruar të kundërshtojë zbatimin e nenit 342 dhe 348 të Kodit të Procedurës Penale për atë kohë sa në këta nene parashikohet rregulli i cili tashmë po kritikohet nga Gjykata Evropiane, pasi sipas kësaj të fundit vendimi i trupës gjykuese nuk përmban arsyetim.

Duket nga dokumentet që janë në dispozicion të gjykatës, në veçanti nga aktakuza, se gjatë hetimeve paraprake, apeluesi, i cili është ndjekur penalisht për vrasje me akuzën e autorit ose të bashkautorit të vrasjes, ka dhënë informacion lidhur me aktet bazuar në të cilat ai ishte akuzuar, informacion i cili është hedhur poshtë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit u mbajt sekret sipas parashikimit të nenit 86 *bis* dhe 86 *ter* të Kodit të Procedurës Penale.

Në parashtrimet që iu depozituan Gjykatës së Krimeve të Rënda në seancën e datës 18 shkurt 2009, apeluesi kërkoi që vendimi kundër tij të ishte i arsyetuar në mënyrë që, në rast të dënimit të tij, ai të mund të kuptonte arsyet që e kishin bindur trupin gjykues për deklarin e tij fajtor, dhe në mënyrë që Gjykata e Kasacionit të mund të rishikonte bazën ligjore të vendimit.

Në lidhje me padinë për vrasje kundër apeluesit, trupit gjykues iu kërkua t'i jepte përgjigje një pyetje kryesore rreth përfshirjes së të akuzuarit në kryerjen e vrasjes me paramendim, një pyetje shtesë për mbrojtjen statusore të provokimit dhe dy pyetjeve për veprën e parashikuar në nenin 401 të Kodit Penal. Trupi gjykues iu përgjigj pyetjes së parë me “po”, pyetjes së dytë me “jo” dhe nuk iu përgjigj të dy pyetjeve të tjera.

Vendimi kundër të cilit u bë apel, e dënoi apeluesin me tetëmbëdhjetë vjet heqje lirie për veprën penale të vrasjes, mbi bazën e vendimit të shprehur vetëm mbi bazën e përgjigjeve afirmative ose negative, të bëra në përputhje me ligjin. Në vendim thuhet se nuk është e nevojshme të jepen arsye të mëtejshme për konstatimin e fajësisë, për shkak se saktësia e pyetjeve justifikon vendimin e shkurtër.

Gjithsesi, vetëm deklarimi i thatë që apeluesi është fajtor për vrasjen dhe që nuk ka faktorë lehtësues nuk i jep arsyet e sakta pse akuzat, e kundërshtuar prej apeluesit, është kontraktuar se është kryer, dhe nuk i jep mundësi kësaj gjykate të rishikojë, *inter alia*, nëse dënimi është bazuar kryesisht në deponimin e një dëshmitari anonim që e inkriminon të akuzuarin, apo është bazuar në prova të tjera mbështetëse në përputhje me nenin 341, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërkohë që bëhet krahasimi me të drejtën belge, e cila nuk u kërkon gjyqtarëve të tillë të japin shpjegime për mënyrën sesi e kanë krijuar bindjen e tyre personale, vendimi është në kundërshtim me nenin 6 të Konventës për atë kohë sa kjo dispozitë mund të kuptohet që e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin deklarin e arsyeve ose dhënien e arsytimit të një vendimi.”

34. Janë dhënë dhe vendime të tjera me efekt të ngjashëm.

3. Reforma legislative

35. Në Belgjikë, që përpara vendimit të Dhomës së Lartë për çështjen *Taxquet*, Senati ka shqyrtuar një projektligj, datë 25 shtator 2008, i cili kërkonte, ndër të tjera, dhe lejimin e kryetarit të Gjykatës së Krimeve të Rënda të ishte i pranishëm në shqyrtimet e trupit gjykues në mënyrë që të ndihmonte anëtarët e tij. Versioni i propozuar i nenit 350 të KPP-së parashikonte që Gjykata e Krimeve të Rënda të arsyetonte vendimet e saj për fajësinë, por nuk kërkonte referimin tek parashtrimet e palëve.

36. Akti i reformës së Gjykatës së Krimeve të Rënda, datë 21 dhjetor 2009, i cili është botuar në *Moniteur belge* më 11 janar 2010 dhe hyri në fuqi më 21 janar 2010, ka prezantuar kërkesën e deklarimit të arsyeve kryesore për Gjykatën e Krimeve të Rënda në vendimet e marra prej saj. Dispozitat përkatëse të KPP-së tani parashikojnë si më poshtë:

Neni 327

“Mbasi i janë bërë dhe i janë dhënë pyetjet anëtarëve të trupit gjykues, ata tërhiqen në sallën e shqyrtimit për shqyrtimin e tyre.

Kryetari i trupit gjykues është ose personi i parë i zgjedhur me short, ose një person i caktuar nga trupi gjykues me pëlqimin e tij ose të saj.

Para fillimit të shqyrtimit, kryetari i trupit gjykues lexon udhëzimin e mposhtëm, i cili shfaqet po ashtu me germa të mëdha në pjesën më të dukshme të sallës së shqyrtimeve: ‘Ligji parashikon që i akuzuari mund të dënohet vetëm nëse është e dukshme nga provat e deklaruar si të pranueshme në procesin gjyqësor se ai është fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm për akuzën e ngritur kundër tij.’”

Neni 328

“Anëtarët e trupit gjykues mund të largohen nga salla e procesit vetëm pasi të kenë marrë vendimin.

Askush nuk lejohet të hyjë në sallë gjatë shqyrtimit të çështjes, për asnjë lloj arsyeje, pa autorizimin me shkrim të Kryetarit të Gjykatës. Kryetari mund të futet në sallën e gjykimit vetëm në rast se atij i kërkohet kjo gjë nga kryetari i trupit gjykues, veçanërisht për t’iu përgjigjur çështjeve ligjore, dhe shoqërohet nga kolegët e tij gjyqtarë, nga i akuzuari dhe nga avokati i tij, pala civile dhe avokati i tij, prokurori dhe sekretari. Në procesverbal bëhet një shënim për këtë rast.

...”

Neni 334

“Gjykata dhe anëtarët e trupit gjykues tërhiqen më pas menjëherë tek salla e shqyrtimeve.

Pa qenë nevoja për të trajtuar të gjitha parashtrimet e depozituara, ata formulojnë arsyet kryesore që çuan në marrjen e vendimit.

Vendimi nënshkruhet nga Kryetari i Gjykatës, nga kryetari i trupit gjykues dhe nga sekretari.”

D. Dispozitat e Kodit Penal

37. Nenet përkatëse të Kodit Penal parashikojnë si më poshtë:

Neni 51

“Kemi të bëjmë me tentativë për kryerjen e një veprë penale në rastet kur ka manifestim të synimit për të kryer një krim të rëndë (*crime*) ose një vepër tjetër të rëndë (*délit*) nëpërmjet sjelljes që përbën objektivisht hapin e parë drejt kryerjes së veprës në fjalë, e cila ndalohet ose nuk arrin të përmbushë synimin vetëm për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të keqdashësit.”

Neni 66

“Personat e mëposhtëm dënohen si autorë të krimeve të rënda, ose si autorë veprash të tjera të rënda:

Personat që kanë kryer veprën penale ose që kanë bashkëpunuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në kryerjen e saj;

Personat, të cilët me anë të çdo akti kanë dhënë ndihmë për kryerjen e veprës penale, pa të cilët vepra nuk do të mund të ishte kryer;

Personat të cilët, me anë të dhuratave, premtimeve, kërcënimeve, abuzimit në detyrë ose kompetence, kompleteve ose mashtrimeve, nxisin në mënyrë të drejtpërdrejtë dikë tjetër për kryerjen e një veprë penale;

Personat që, me anë të fjalimeve në vende ose asamble publike, ose nëpërmjet mënyrave me shkrim ose të printuara, me imazhe ose me emblema, të shpërndara ose të shitura, të ofruara për shitje ose për ekspozim në një vend që mund të shihet prej publikut, nxisin në mënyrë të drejtpërdrejtë një person tjetër për kryerjen e veprës penale, pa paragjykim në lidhje me sanksionet e parashikuara nga ligji kundër atyre që nxisin të tjerët për kryerjen e veprave penale, dhe në rastet kur këto nxitje nuk kanë efekt.”

Neni 67

“Personat e mëposhtëm dënohen si bashkëpunëtor në kryerjen e një krimi të rëndë ose të një tjetër veprë të rëndë:

Personat që japin udhëzime për kryerjen e krimit;

Personat që prodhojnë armë, mjete ose çdo lloj tjetër instrumenti që përdoret për kryerjen e krimit, duke qenë në dijeni që ato do të përdoren për kryerjen e krimit;

Personat që me dijeni kanë ndihmuar autorin ose autorët e krimit për aktet përgatitore ose lehtësuese për kryerjen e krimit, ose për përfundimin e tij, në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga paragrafi 3 i nenit 66.”

Neni 393

“Akti i kryer me qëllimin e shkakimit të vdekjes së dikujt cilësohet si vrasje (*meurtre*). Ajo dënohet (me njëzet vjet heqje lirie).”

Neni 394

“Vrasja e kryer me paramendim cilësohet si vrasje me paramendim (*assassinat*). Ajo dënohet (me burgim të përjetshëm).”

E. Ligji, datë 1 prill 2007, i cili ndryshon Kodin e Procedurës Penale për lejimin e rihapjes së proceseve penale

38. Ligji i datës 1 prill 2007 (i cili është botuar në *Moniteur belge* më 9 maj 2007 dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2007) u jep të drejtë personave të dënuar të kërkojnë rihapjen e proceseve të tyre gjyqësore pas një konstatimi të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të Konventës.

39. Neni 442 *bis* i KPP-së parashikon:

“Në rast se Gjykata Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka konstatuar në një vendim përfundimtar të saj shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, ose të Protokolleve të saj (më poshtë ‘Konventa Evropiane’), mund të bëhet kërkesë për rihapjen e çështjes vetëm në lidhje me çështjet penale për procesin që çoi në dënimin e kërkuarit të çështjes para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ose në rastin e dënimit të një personi tjetër për të njëjtën akuzë mbi bazën e të njëjtave prova.”

40. Neni 442 *ter* i Kodit parashikon:

“Personat e mposhtëm konsiderohen të kenë të drejtën për kërkesë për rishqyrtim të çështjeve të tyre:

(1) personat e dënuar;

(2) në rast se personi i dënuar ka vdekur, i është mohuar aftësia ligjore për të vepruar, ose është deklaruar i pagjurmueshëm, bashkëshorti/bashkëshortja e personit, bashkëjetuesi/ja ligjshëm, fëmijët, vëllezërit dhe motrat e tij/saj;

(3) Kryeprokurori Publik në gjykatën e Kasacionit, me mocionin e tij ose me iniciativën e Ministrisë së Drejtësisë.”

41. Neni 442 *quinquies* i PKK-së parashikon:

“Në rastet kur duket nga shqyrtimet e çështjeve që ose vendimi objekt shqyrtimi është në shkelje të Konventës Evropiane për themelin e çështjes, ose që shkelja e konstatuar ka ardhur si rezultat i gabimeve ose mangësive procedurale kaq të theksuar saqë hidhet dyshim për rezultatin e procesit në fjalë, Gjykata e Kasacionit urdhëron rihapjen e procesit, me kusht që personi i dënuar, ose personat që kanë të drejtë ta hapin çështjen në kuptimin e nenit 442 *ter*, pika (2), vazhdojnë të vuajnë pasojat shumë negative të cilat nuk mund të kompensohen ndryshe përveçse me anë të rihapjes së çështjes për shqyrtim.”

42. Pas një vendimi të Gjykatës në çështjen *Da Luz Domingues Ferreira k. Belgjikës* (nr. 50049/99, datë 24 maj 2007), Gjykata e Kasacionit, në vendimin e saj, datë 9 prill 2008, urdhëroi rihapjen e çështjes dhe e tërhoqi vendimin që kishte dhënë më 6 janar 1999 (*Journal des tribunaux*, 2008, f. 403).

III. E DREJTA E KRAHASUAR

43. Është e qartë që ekzistojnë modele të ndryshme gjykimi nga persona jashtë sistemit të drejtësisë në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ka ndryshime të cilat reflektojnë veçanti kulturore dhe historike dhe brenda

shteteve që kanë përzgjedhur modelin “tradicional” të gjykimit me anë të trupit gjykues të përbërë dhe nga gjyqtarë jo profesionistë, por tipari dallues i tyre është që gjyqtarët profesionistë nuk kanë mundësi të marrin pjesë në shqyrtimet e gjyqtarëve jo profesionistë gjatë marrjes së vendimit.

44. Shtetet anëtare mund të ndahen në tri kategori: shtetet të cilat nuk kanë një formë të tillë gjykimi, dhe nuk kanë asnjë model gjykimi që realizohet nga persona që nuk janë gjyqtarë në profesion; shtete të cilat përdorin modelin e përzier të gjykatës me gjyqtarë jo profesionistë të cilët marrin pjesë dhe e shqyrtojnë çështjen së bashku me gjyqtarët profesionistë; dhe shtetet të cilat për çështjet penale kanë përzgjedhur modelin “tradicional” të gjykimit nga gjyqtarë jo profesionistë.

45. Ndërmjet modeleve të përmendura më lart, katërmëdhjetë shtete anëtare të Këshillit të Evropës nuk kanë pasur asnjëherë një sistem të tillë, si dhe as dhe ndonjë lloj forme gjykimi nga njerëzit e thjeshtë (gjyqtarë jo profesionistë në çështjet penale), ose e kanë hequr këtë sistem. Këto vende janë: Shqipëria, Andorra, Armenia, Azerbajxhani, Bosnja dhe Hercegovina, Qiproja, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Moldavia, Holanda, Rumania, San Marino dhe Turqia. Në këto shtete çështjet penale gjykohen ekskluzivisht nga gjyqtarë profesionistë.

46. Shtetet anëtare me sistem të përzier janë: Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Italia, Lihtenshtajni, Monakoja, Mali i Zi, Norvegjia (në pjesën më të madhe të rasteve), Polonia, Portugalia, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Suedia, “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” dhe Ukraina. Sistemi i përzier, i cili mund të funksionojë dhe paralelisht me modelin tradicional të trupit gjykues me gjyqtarë jo profesionistë karakterizohet nga fakti që gjyqtarët profesionistë dhe ata jo profesionistë i përcaktojnë bashkërisht të gjitha çështjet e ligjit dhe të faktit, çështjen e fajësisë dhe dënimin.

47. Dhjetë shtetet anëtare të cilat kanë përzgjedhur një sistem tradicional gjykimi janë: Austria, Belgjika, Gjeorgjia, Irlanda, Malta, Norvegjia (vetëm në çështjet e krimeve të rënda në apel), Federata Ruse, Spanja, Zvicra (Kantoni i Gjenevës), deri më 1 janar 2011, dhe Mbretëria e Bashkuar (Anglia, Uellshi, Skocia dhe Irlanda e Veriut).

48. Në formën e saj tradicionale, gjykimi nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarë jo profesionistë përfshin një kombinim të këtyre personave që punojnë me një ose më shumë gjyqtarë profesionistë. Numri i gjyqtarëve jo profesionistë ndryshon nga njëri shtet në tjetrin dhe në varësi të objektit të çështjes. Numri i gjyqtarëve profesionistë ndryshon nga njëri shtet në tjetrin. Në Irlandë, Maltë, Rusi, Spanjë, Zvicër dhe në Mbretërinë e Bashkuar gjykata dhe trupi gjykues drejtohen nga një gjyqtar i vetëm. Në Austri, Belgjikë dhe në Norvegji, trupi gjykues përbëhet prej tre gjyqtarëve profesionistë së bashku me gjyqtarët jo profesionistë. Gjyqtarët profesionistë nuk mund të marrin pjesë në shqyrtimet e gjyqtarëve jo

profesionistë lidhur me çështjen e fajësisë, gjë e cila është kompetencë ekskluzive e gjyqtarëve jo profesionistë.

49. Në disa shtete gjyqtarëve jo profesionistë u paraqitet një listë pyetjesh specifike përpara se ata të tërhiqen për shqyrtimin e fakteve të çështjes. Këtë praktikë e ndjekin shtatë shtete, që janë: Austria, Belgjika, Irlanda, Norvegjia, Rusia, Spanja dhe Zvicra.

50. Në Irlandë, Angli dhe Uells, në fund të provave, gjyqtari bën një përmbledhje të çështjes për gjyqtarët jo profesionistë. Ai u kujton atyre provat që kanë dëgjuar gjatë procesit. Ndërkohë që e jep këtë sqarim, gjyqtari mund të japë udhëzime lidhur me qasjen e duhur bazuar në provat e paraqitura. Ai po ashtu u jep informacion dhe shpjegime gjyqtarëve jo profesionistë lidhur me rregullat ligjore të zbatueshme. Në këtë kuadër, gjyqtari bën sqarimin e elementëve të veprës penale dhe përcakton zinxhirin e arsyetimeve që duhet të ndiqen në mënyrë që të arrihet një vendim mbi bazën e gjetjeve të faktit nga trupi gjykues.

51. Në Norvegji gjyqtari profesionist i udhëzon gjyqtarët jo profesionistë për çështjet ligjore të ngritura dhe u shpjegon rregullat që duhet të ndiqen prej tyre kur të tërhiqen për të marrë vendimin. Në fund të procesit gjyqësor, gjyqtari profesionist bën po ashtu një përmbledhje të provave për anëtarët jo profesionistë, ose tërheq vëmendjen e tyre për provat e rëndësishme.

52. Në Austri vendimi i gjyqtarëve jo profesionistë arrihet mbi bazën e një pyetësoi që përcakton elementët kryesorë të akuzave të ndryshme dhe që përmban pyetje që kërkojnë një përgjigje “po” ose “jo”.

53. Në parim, trupat gjykues të përbërë me gjyqtarë jo profesionistë e shqyrtojnë çështjen me dyer të mbyllura, pa praninë e gjyqtarit drejtues. Në të vërtetë, sekreti i shqyrtimeve të këtij trupi gjykues është parim shumë strikt në shumë shtete.

54. Në Belgjikë një gjyqtar profesionist mund të ftohet të marrë pjesë së sallën e shqyrtimit për t'i dhënë gjyqtarëve jo profesionistë qartësime për një çështje specifike, pa qenë në gjendje të shprehë një pikëpamje ose të votojë për çështjen e fajësisë. Në Norvegji trupi gjykues me gjyqtarë jo profesionistë mund t'i bëjë pyetje gjyqtarit drejtues, por nëse trupi gjykues është i mendimit se ka nevojë për qartësime të mëtejshme lidhur me pyetjet që kërkojnë të marrin përgjigje, për parimet ligjore të zbatueshme ose për procedurën që duhet të ndiqet, ose në rast se pyetjet duhet të ndryshohen ose duhet t'i bëhen pyetje të reja trupi gjykues duhet të kthehet në seancë të rregullt gjyqi, në mënyrë që çështja ose çështjet të ngrihen në prani të palëve.

55. Në Kantonin e Gjenevës, gjyqtari drejtues merr pjesë në shqyrtimet e trupës gjykuese me gjyqtarë jo profesionistë për të dhënë ndihmë, por nuk mund të japë mendim lidhur me çështjen e fajësisë. Po ashtu, është i pranishëm dhe një Sekretar për të mbajtur shënim vendimet e marra dhe arsyetimet e dhëna.

56. Rregulli i përgjithshëm duket se është që nuk jepen arsyetime për vendime të marra nga një trup tradicional gjykimi. Kështu ndodh në të gjitha shtetet që e kanë këtë sistem, në përjashtim të Spanjës dhe Zvicrës (Kantoni i Gjenevës).

57. Në Spanjë vendimi i trupit gjykues përbëhet prej pesë pjesëve të dallueshme. Në pjesën e parë jepet lista e fakteve që janë të vërtetuara, lista e dytë përmban listën e fakteve të rrëzuara, lista e tretë përmban deklaratën e trupit gjykues lidhur me deklarinimin fajtor ose jo të të akuzuarit, dhe lista e katërt përmban një deklarinim të shkurtër të arsyeve që mbështesin vendimin, duke dhënë provat mbi të cilat bazohet vendimi dhe arsyet pse fakte të caktuara janë deklaruar si të pranueshme dhe të qenësishme ose jo. Pjesa e pestë përmban një përmbledhje të të gjithë gjërave që u trajtuan në diskutime, duke shmangur çdo identifikim që mund të cenojë sekretin e hetimeve.

58. Deri në vitin 1991, organet e Kantonit të Gjenevës ishin të mendimit që trupi gjykues me gjyqtarë jo profesionistë i plotësonte kërkesat e një vendimi të arsyetuar me anë të përgjigjeve “po” ose “jo” për pyetjet precize që i bëheshin atij. Por, në një vendim, datë 17 dhjetor 1991, Gjykata Federale konstatoi se këto përgjigje ishin të pamjaftueshme dhe i kërkoi trupave gjykuese në Kanton të jepnin arsye për vendimet e tyre në të ardhmen. Në vitin 1992, u ndryshuan nenet 298 dhe 308 të Kodit të Procedurës Penale të Gjenevës për t’i kërkuar trupit gjykues të jepte arsyet për vendimet e tij, nëse e mendonte se kjo gjë ishte e nevojshme për kuptimin e vendimit të tij. Neni 327 i Kodit të Procedurës Penale i kërkon trupit gjykues të deklarojë *“arsyet për marrjen parasysh ose jo të provave kryesore dhe të arsyeve ligjore për vendimin e trupit gjykues të përbërë nga gjyqtarë jo profesionistë dhe vendimin e gjykatës dhe të trupit gjykues lidhur me dënimin ose përcaktimin e masave”*.

59. Brenda shteteve që kanë përzgjedhur një sistem tradicional gjykimi, ekziston e drejta e apelit kundër vendimit të marrë nga një sistem tradicional gjykimi në Gjeorgji, Irlandë, Maltë, Spanjë, Suedi dhe në Mbretërinë e Bashkuar, ndërkohë që nuk ka sistem apeli në Austria, Belgjikë, Norvegji, Rusi dhe Zvicër (Kantonin e Gjenevës). Në Austri, personat e dënuar mund të apelojnë vetëm në Gjykatën e Apelit; po ashtu, në Austri mund të bëhet kërkesë për pavlefshmëri procesi në Gjykatën e Lartë.

60. Në Belgjikë që prej zhvillimeve për shkak të çështjes në fjalë, ligji datë 21 dhjetor 2009, i cili hyri në fuqi më 21 janar 2010 (shih paragrafin 36 më lart), ka ndryshuar procedurën në Gjykatën e Krimeve të Rënda, duke i kërkuar shprehimisht gjykatës të japë arsyet kryesore për vendimin e marrë nga trupi gjykues për të sqaruar kuptimin e tij.

LIGJI

I. QËLLIMI I ÇËSHTJES PARA DHOMËS SË MADHE

61. Në komentet e tij para Dhomës së Madhe, kërkuesi përsëriti të gjitha ankesat e ngritura në çështjet që ka depozituar në Gjykatë. Në vendimin e saj, datë 13 janar 2009, Dhoma i deklaroi ankesat lidhur me mos dhënien e arsyeve nga vendimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda (neni 6 § 1) dhe për të marrë në pyetje dëshmitarin anonim (neni 6 § 3 (d)) të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankesave të papranueshme. Për rrjedhojë, Dhoma e Madhe do të shqyrtojë vetëm ankesat e deklaruara të pranueshme prej saj, pasi “çështja” që i është drejtohet konsiderohet vetëm ajo pjesë e padisë që deklarohet e pranueshme nga Dhoma (shih, ndërmjet autoritetesh të tjera, *K. dhe T. k. Finlandës* [GC], nr. 25702/94, §§ 140-41, ECHR 2001-VII).

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

62. Kërkuesi pretendoi para Gjykatës shkeljen e të drejtës së tij për proces të rregullt ligjor për shkak të faktit se dënimi i tij nga Gjykata e Krimeve të Rënda ishte bazuar mbi një vendim fajësie që nuk përmbante arsyet e vendimit dhe që nuk mund të apelohej në një organ me juridiksion të plotë mbi çështjen. Kërkuesi pretendon shkelje të nenit 6 § 1, pjesa përkatëse e të cilit parashikon se:

“në përcaktimin e ... çdo akuze penale kundër tij, çdokush ka të drejtën e një procesi të rregullt ligjor ... nga [një] ... gjykatë ...”

A. Vendimi i Dhomës

63. Në vendimin e saj, datë 13 janar 2009, Dhoma konstatoi shkelje të së drejtës së kërkuesit për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 6 § 1 i Konventës. Ajo u shpreh se pyetjet për gjyqtarët jo profesionistë ishin formular në mënyrë të tillë që nuk mund të thuhej me siguri se pse secila prej tyre kishte marrë përgjigje afirmative, ndërkohë që kërkuesi i kishte mohuar të gjitha përfshirjet personale në veprat për të cilat ishte akuzuar. Dhoma shtoi më tej se përgjigje të tilla lakonike për pyetje të përgjithshme dhe opake mund ta kishin lënë kërkuesin me përshtypjen e një drejtësie arbitrare që i mungon transparenca. Duke mos marrë një përmbledhje të arsyeve kryesore pse Gjykata e Krimeve të Rënda ishte bindur për fajësinë e tij, kërkuesi nuk ishte në gjendje të kuptonte dhe, për pasojë, ta pranonte, vendimin e gjykatës. Dhoma u shpreh se në përgjithësi, për shkak se trupi gjykues nuk e kishte arritur vendimin mbi bazën e dosjes së çështjes, por mbi bazën e provave që kishte dëgjuar në gjykatë, ishte e domosdoshme që ajo të theksonte elementët që e kishin bindur trupin gjykues për arsyet pse

secila nga pyetjet ishte përgjigjur në mënyrë afirmative ose mohuese për qëllim të shpjegimit të vendimit si për të akuzuarin dhe për publikun në përgjithësi.

B. Parashtrimet e palëve

1. Kërkuesi

64. Kërkuesi parashtroi se dënimi i tij ishte bazuar në vendimin e fajësisë, i cili nuk përfshinte asnjë arsye dhe nuk kishte qenë objekt i asnjë forme apeli. Për shkak se çështja kishte qenë shumë komplekse si lidhur me pjesën e faktit dhe ato ligjore, ishte e vështirë për dymbëdhjetë gjyqtarë jo profesionistë, pa kualifikimet e nevojshme ligjore, të ishin në gjendje të bënin një vlerësim ligjor për themelin e çështjes të akuzave kundër tij. Mungesa e arsytimit në vendimin e fajësisë e përjashtonte çdo mundësi të rishikimit gjyqësor të arsyeve mbi të cilat ishte bazuar vendimi i trupit gjykues. Vetëm fakti i thjeshtë që neni 364 *bis* i KPP-së parashikon që çdo gjyqtar që dënonte një të akuzuar duhej të përmendte arsyet për përcaktimin e dënimit nuk ishte i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesën për arsyetim të kërkuar nga neni 6 i Konventës.

65. Duke iu referuar çështjes *Ruiz Torija k. Spanjës* (9 dhjetor 1994, Seritë A nr. 303-A) dhe *Papon k. Francës* ((dec.), nr. 54210/00, GJEDNJ 2001-XII), kërkuesi theksoi se detyrimi për dhënien e arsyeve parashikohet në jurisprudencën e Gjykatës, megjithëse Gjykata e kishte cilësuar atë në disa mënyra të ndryshme. Gjithsesi, ai shtoi se çështja e tij nuk mund të krahasohen me çështjen e Maurice Papon-it, në të cilën Papon-i kishte pasur mundësi të nxirrte një grup arsyesh nga të 768 përgjigjet e dhëna për pyetjet që i ishin drejtuar trupit gjykues. Këto përgjigje kishin dhënë një indicie pse Gjykata franceze kishte deklaruar fajësinë e tij duke e dënuar atë. Në çështjen në fjalë, pyetjet që i ishin bërë trupit gjykues nuk trajtonin në asnjë mënyrë thelbin e çështjes. Ishin bërë shumë pak pyetje, vetëm katër nga pyetjet kishin të bënin me kërkuesin, dhe ato lidheshin vetëm me faktin nëse ai ishte fajtor për vrasje ose për tentativë për vrasje. Pyetjet ishin përgjigjur me “po” pa marrë shpjegime të mëtejshme.

66. Në parashtrimin e kërkuesit ka tre argumente të bazuara në logjikën ligjore të cilat të çojnë në qëndrimin që u kërkon gjykatave të krimeve të rënda të japin arsyet për vendimet që ato marrin. Dy arsytet e para bazohen në nenin 6 § 1 të Konventës. Së pari, jurisprudenca ka pranuar se vendimet e arsyetuara të gjykatës përbëjnë pjesë të garancive për një proces të rregullt ligjor. Nuk do të ishte logjike që standardi e kërkuar në këtë fushë të ishte më i ulët për proceset që përfundonin në dënime më të ashpra penale. Së dyti, neni 6 § 1 thekson me forcë natyrën publike të drejtësisë. Argumenti i tretë bazohet në nenin 6 § 3 (a), i cili pranon se çdokush i akuzuar me një veprë penale ka të drejtë të informohet në detaje për natyrën dhe shkakun e

akuzave kundër tij. Kërkuesi pretendon që kjo e drejtë duhet të shtrihet dhe për shkakun e dënimit të tij. Çështja e dhënies së drejtësisë së gabuar po ashtu mbështet pikëpamjen e dhënies së arsyeve për vendimin. Fakti i kërkesës së një gjykate për të dhënë arsyet për një vendim do të thotë që gjykata duhet të shprehë një linjë koherente dhe racionale për të dhënë arsyet, të zhveshur nga të gjitha aspektet emocionale dhe subjektive. Së fundmi, përfshirja e arsyeve në vendim e bënte të mundur rishikimin nga gjykatat e apelit dhe të kasacionit; një rishikim i tillë nuk do të kishte aspak të njëjtin qëllim në rastin kur nuk jepeshin arsyet e fajësisë në vendim.

2. *Qeveria*

67. Së pari, qeveria vërejtë se sistemet ligjore evropiane dalloheshin nga diversiteti i madh i tyre: disa prej tyre nuk kishin pasur asnjëherë, ose nuk kishin në sistemin e tyre gjykimin nga gjyqtarë jo profesionistë, ndërkohë që disa shtete të tjera i kishin këto sisteme; po ashtu Qeveria theksoi se funksionimi i këtyre trupave gjykues dhe roli që u besohej atyre ndryshon nga një shtet tek tjetri. Për më tepër, Gjykata nuk është një organ i shkallës së tretë ose të katërt. Detyra e saj nuk është të vendoste në abstrakt ose të standardizonte sistemet e ndryshme ligjore, por të siguronte që procedura e saj i plotësonte kërkesat e nenit 6 të Konventës.

68. Në Belgjikë legjitimiteti i gjykatave të krimeve të rënda sigurohet nga institucioni i trupit gjykues. Gjyqtarët jo profesionistë përfaqësojnë popullin, dhe duke qenë kështu gëzonin legjitimitet institucional. Përbërja e trupit gjykues ishte garancia kryesore kundër drejtësisë arbitrare.

69. Mungesa e arsyeve të shprehura nuk nënkupton që vendimi i fajësisë nuk është arritur si rezultat i një procesi arsyetimit, të cilin personat e përfshirë janë në gjendje të ndjekin dhe të rindërtojnë. Për më tepër, Gjykata nuk ka konstatuar asnjëherë që mungesa e arsyeve në vendimet e gjykatave të tilla popullore ngrinte një çështje në abstrakt në kuptimin e nenit 6 të Konventës. Megjithatë Gjykata është shprehur në çështjen *Göktepe k. Belgjikës* (nr. 50372/99, 2 qershor 2005) që është e nevojshme që ajo të bënte pyetje të qarta në lidhje me secilin të pandehur për praninë e rrethanave rënduese, ajo nuk e ka kundërshtuar funksionimin e Gjykatave të Krimeve të Rënda, ose mungesën e arsyeve në vendimet e arritura në gjykata të tilla sipas ligjit belg.

70. Kryerja e proceseve në gjykatat e krimeve të rënda belge siguron që çdo i akuzuar është në gjendje të marrë një vendim të arsyetuar për ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e provave dhe për të pasur ide të mjaftueshme të provave që kanë qenë vendimtare për vendimin dhe, sipas nevojës, dhe të argumenteve të mbrojtjes që janë marrë parasysh nga trupi gjykues për arritjen e një vendimi. Në rastin në fjalë, pyetjet e formuluar në fund të proceseve gjyqësore nga Kryetari i Gjykatës së Krimeve të Rënda së Liège-s në lidhje me fajësinë e ankimuesit kanë qenë mjaftueshmërisht të sakta për të shërbyer si bazë e përshtatshme për vendimin e gjykatës.

Elementët përbërës të veprës dhe të akteve kundër tij ishin dëshmuar qartë, ashtu si edhe rrethanat rënduese. Kërkuesi është njohur me aktakuzën dhe kishte mundësi të merrte pjesë në seancat gjyqësore të gjata në të cilat janë shqyrtuar provat. Për rrjedhojë, është pa vlerë që kërkuesi të pretendojë se nuk ka qenë në dijeni të arsyeve të dënimit. Vetëm fakti që anëtarët e trupit gjykues arritën në marrjen e vendimit mbi bazën e bindjeve të tyre personale nuk çon në shkelje të Konventës.

3. Ndërrhyrjet e palëve të treta

(a) Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar

71. Qeveria e Mbretërisë së Madhe parashtroi se ishte a qartë nga jurisprudenca e Gjykatës, në veçanti nga çështja *Saric k. Danimarkës* ((ven.), nr. 31913/96, 2 shkurt 1999), që gjykimi nga një trup gjykues i përbërë nga gjyqtarë jo profesionistë nuk konsiderohet si në kundërshtim me Konventën. Nuk ekziston detyrimi absolut i gjykatës që të japë arsye për çdo vendim, ndërkohë që qasja e Gjykatës ishte mjaftueshmërisht fleksibël për të trajtuar veçantitë e këtij sistemi gjykimi.

72. Ndërkohë që e drejta e një të akuzuari për proces të rregullt ligjor nuk duhet të komprometohet kurrë, kjo e drejtë mund të realizohet në mënyra të ndryshme nga sistemet e drejtësisë penale të shteteve palë në Konventë. Shtetet duhet të kenë një prag vlerësimi në organizimin e atyre procedurave gjyqësore nëpërmjet të cilave sigurohet e drejta për proces të rregullt ligjor. Pyetjet dhe përgjigjet e trupit gjykues nuk konsiderohen në izolim, por në kuadrin e proceseve në tërësi, duke marrë parasysh garancitë procedurale dhe mundësitë e apelimit.

73. Çështja e rëndësishme që shtrohet është nëse, duke e parë të gjithë procesin gjyqësor në tërësi, personi i dënuar ishte në dijeni të akuzave kundër tij, të përmbajtjes ligjore të veprës për të cilën ai akuzohej dhe të bazës që përbënte vendimin kundër tij.

74. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar parashtroi se në sistemin britanik, për trupat gjykuese me gjyqtarë jo profesionistë, në fund të provave, gjyqtari bën përmbledhje të çështjes për ta. Gjyqtari u kujton atyre provat që kanë dëgjuar në këtë proces. Gjatë kësaj pune, ai mund të japë udhëzime për qasjen e duhur, ose për pozicionin që duhet mbajtur lidhur me një provë të caktuar. Ai po ashtu i jep trupit gjykues informacion dhe shpjegime për rregullat ligjore të zbatueshme.

Në këtë moment, ai shpjegon elementët përbërës të veprës penale dhe përcakton zinxhirin e arsyeve që duhet të ndiqen për të marrë një vendim bazuar në konstatimet e faktit. Si akuza dhe mbrojtja duhet të bëjnë parashtrimet për përfundimin, i cili përcaktohet nga trupi gjykues, sipas mendimit të tyre.

75. Trupi gjykues e shqyrton çështjen me dyer të mbyllura. Në rast se ai kërkon shpjegime ose udhëzime të mëtejshme për ndonjë pikë të caktuar, ai

mund t'i dërgojë një shënim gjyqtarit, duke përcaktuar pyetjet për të cilat i nevojiten sqarime. Gjyqtari ia tregon shënimin palëve të akuzës dhe të mbrojtjes, në mungesë së trupit gjykues, dhe i fton ata për parashtrimet e tyre lidhur me një përgjigje të përshtatshme. Më pas ai është i lirë të vendosë nëse trupi gjykues duhet të marrë udhëzime të mëtejshme në seancë të hapur.

(b) Qeveria irlandeze

76. Në parashtrimet e qeverisë irlandeze, sistemi i trupit gjykues të përbërë nga gjyqtarë jo profesionistë përbën përzgjedhjen unanime të personave të akuzuar dhe të mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe konsiderohet si baza e sistemit të drejtësisë penale në vend. Nuk ka pasur asnjëherë asnjë ankese për mungesë transparence nga sistemi, ose për pengim ose cenim të të drejtave të të akuzuarit prej këtij sistemi. Sistemi i jep besim irlandezëve, të cilët ndihen shumë të lidhur me këtë sistem për shkak të arsyeve historike, ose të arsyeve të tjera.

77. Qeveria irlandeze vëren se në të drejtën irlandeze, udhëzimet e gjyqtarit për trupën gjykuese të përbërë nga gjyqtarë jo profesionistë përbëjnë kornizën e vendimin të kësaj të fundit. Gjyqtari i udhëzon anëtarët e trupit gjykues për të gjitha çështjet ligjore të ngritura dhe u shpjegon rregullat që ata duhet të ndjekin kur e shqyrtojnë çështjen, në mënyrë që të arrijnë në një vendim. Në fund të procesit gjyqësor, ai bën një përmbledhje për anëtarët e trupit gjykues, ose u tërheq atyre vëmendjen lidhur me provat e rëndësishme. Ai e këshillon trupin gjykues për kërkesat për prova për ofrim të bazës së mjaftueshme për mbështetjen e fajësisë së të akuzuarit, për natyrën shkak-pasojë ose të drejtpërdrejtë të provave të caktuara, ose për qëllimin e provave të depozituara. Avokati i të akuzuarit ka të drejtë të pyesë gjyqtarin t'i shpjegojë udhëzimet që i jepen trupit gjykues në rast se ato konsiderohen si të papërshtatshme, të pamjaftueshme ose të paqarta në ndonjë mënyrë. Në rast se trupi gjykues kërkon shpjegime ose udhëzime të mëtejshme për një pikë të caktuar, ai mund t'i kërkojë gjyqtarit të veprojë sipas nevojës.

78. Qeveria irlandeze shprehet se si ka mundësi që një sistem gjykimi që ka funksionuar për shekuj me radhë, i cili ka ekzistuar shumë kohë më parë se të ekzistonte Konventa, tani mund të konsiderohet në shkelje të nenit 6 §. 1. Vendimi i Dhomës nuk e ka marrë parasysh mjaftueshmërisht procedurën e gjykatave të tilla si të tërë, ndërkohë që ekzistojnë garanci në Belgjikë dhe në shtete të tjera. Gjykata duhet të kishte shqyrtuar nëse ndonjë ndryshim në rregullat e tjera procedurale, ose të rregullave të provës mund të kishte ndihmuar në marrjen e vendimit. Në çështjen *Gregory k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim*, (datë 25 shkurt 1997, *Raportet e Vendimeve dhe të Gjykimeve* 1997–I) Gjykata ka pranuar se sekret i shqyrtimeve të trupit gjykues është tipar vendimtar dhe legjitim i së drejtës së gjykimit në Angli, që shërben për të përforcuar rolin e trupit gjykues si arbitri përfundimtar i

faktit dhe për të garantuar shqyrtime të hapura dhe miqësore ndërmjet anëtarëve të trupit gjykues mbi bazën e provave që ata kanë dëgjuar.

79. Qeveria irlandeze deklaroi se konfidencialiteti i shqyrtimit të trupit gjykues gërshetohet me mungesën e arsyeve. Kërkimi i dhënies së arsyeve të vendimit nga trupi gjykues do të ndryshonte vetë thelbin e gjykimit të këtyre gjykimin në Irlandë.

(c) Qeveria franceze

80. Në parashtrimet e qeverisë franceze, e drejta pozitive nuk kërkon arsyetim të vendimeve të gjykatave penale të përbëra nga gjyqtarë jo profesionistë, dhe as që është kërkuar ndonjëherë kjo gjë që prej prezantimit të këtyre gjykatave. Veçantitë kryesore të procedurës së gjykatave të tilla bazohen në tri tipare kryesore: natyra gojore dhe e pandërprerë e procesit dhe rregulli i dënimit personal. Këto karakteristika, të cilat rrjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pjesëmarrja e qytetarëve në aktin e gjykimit, kanë çuar në qëndrimin kundër dhënies së arsyeve për vendimet e marra nga këto gjykata në të drejtën franceze. Parimi i mosdhënies së arsyeve është përcaktuar pa ekuivok në nenin 353 të Kodit të Procedurës Penale, ku ky parim lidhet me parimin e dënimit personal, i cili është përcaktuar shprehimisht: vendimi i anëtarëve të trupit gjykues nuk duhet të diktohet nga standardet ose rregullat ligjore, por nga shqyrtimi, nëpërmjet “ndërgjegjes” dhe “aftësiwe racionale”, nga provat e dëgjuara në proceset ku palët kanë shprehur mendimet e tyre. Gjykata franceze e Kasacionit është shprehur se i vetmi “arsyetim” ligjor i pranueshëm në vendimin e një gjykate *krimesh të rënda* përbëhet nga përgjigjet për pyetjet që i bëhen trupit gjykues me fjalët e thjeshta “po” se “jo”. Ka pasur propozime për ndryshimin e parimit të mos përfshirjes së arsyeve, por Parlamenti francez nuk i ka miratuar kurrë këto propozime.

81. Megjithëse një ose më shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës e kanë prezantuar sistemin e dhënies së arsyeve që çojnë në marrjen e një vendimi nga trupi gjykues, ky argument nuk mund të justifikohet nga jurisprudenca e Gjykatës dhe nga baza për konstatimin e shkeljes së Konventës. Diversiteti ekstrem ndërmjet sistemeve ligjore lidhur me përfshirjen e gjyqtarëve jo profesionistë në gjykimin e disa veprave penale përjashton një vlerësim të përgjithshëm të një çështje të tillë të përgjithshme si përfshirja e arsyeve në vendim. Vetë fakti që reforma është miratuar në një vend të caktuar nuk do të thotë që ajo ka pasur mbështetje unanime atje. Për më tepër, një qasje e përdorur në një vend jo domosdoshmërisht mund të transpozohet në një vend tjetër.

82. Qeveria franceze argumenton më tej se Gjykata nuk duhet t’i shtrijë kompetencat e saj në harmonizimin e të drejtës së brendshme të shteteve palë; bërja e kësaj gjëje do të paralizonte sistemet ligjore dhe do të cenonte si autoritetin e vendimeve të saj dhe procesin e rregullt demokratik në shtetet anëtare. Ekziston një rrezik i madh që largimet nga jurisprudenca e

përcaktuar mund të diskreditojnë jo vetëm vendimet e Gjykatës, por edhe vetë konceptin e të drejtave të njeriut. Është detyrë e Gjykatës që të sigurojë që zhvillimet në legjislacionin e brendshëm të jenë të përputhje me Konventën, por Gjykata mund të zërë vendin e sistemit demokratik për ndryshimet e sistemit ligjor, të ngjizur në historinë dhe kulturën individuale të shteteve, vetëm duke treguar kujdes të jashtëzakonshëm dhe një frymë të lartë modeli, veçanërisht nëse ajo ka vendosur më parë që këto sisteme janë në përputhje me Konventën. Qasja ndryshe nga precedenti i vendosur nga Seksioni i Dytë i Gjykatës ka krijuar probleme për funksionimin normal të gjykatave jo vetëm në Belgjikë, por edhe në Francë. Po ashtu, nuk mund të përjashtohet rreziku i rishqyrtimit të proceseve të gjykuara nga gjykatat e krimeve të rënda, gjë e cila do të ketë pasoja të mëdha organizative, por mbi të gjitha pasoja njerëzore.

C. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e përgjithshme

83. Gjykata vëren se shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës kanë sistemin e gjykimit me gjykata të përbëra nga gjyqtarë jo profesionistë, të udhëhequr nga dëshira legjitime e përfshirjes së qytetarëve në administrimin e drejtësisë, në veçanti në lidhje me veprat më të rënda. Trupa të tilla gjykimi kanë forma nga më të ndryshmet në shtete të ndryshme, duke reflektuar historikun e shtetit, traditën dhe kulturën e tyre ligjore; ndryshimet mund të lidhen me numrin e gjyqtarëve jo profesionistë, kualifikimet e tyre, mënyrën në të cilën ata emërohen, dhe nëse bëhet ndonjë apel i çdo lloj forme kundër vendimeve të tyre (shih paragrafët 43-60 më sipër). Ky është një ndër shembujt për ilustrimin e ndryshimeve të mëdha të sistemeve ligjore që ekzistojnë në Evropë, dhe nuk është detyrë e Gjykatës që t'i standardizojë këtë sisteme. Përzgjedhja e një sistemi të caktuar të drejtësisë penale nga një shtet, në parim është diçka që shkon përtej mbikëqyrjes së ushtruar nga Gjykata në nivelin evropian, me kusht që sistemi i përzgjedhur të mos cenojë parimet e parashikuara në Konventë (shih *Achour k. Francës* [GC], nr. 67335/01, § 51, GJEDNJ 2006-IV). Për më tej, në çështjet që dalin nga kërkesat individuale, detyra e Gjykatës nuk është të rishikojë legjislacionin përkatës në abstrakt. Në të kundërtën, Gjykata duhet ta kufizojë veten, për aq sa është e mundur, në shqyrtimin e çështjeve që ngrihen para saj (shih, ndërmjet të tjerash, *N.C. k. Italisë* [GC], nr. 24952/94, § 56, ECHR 2002-X).

84. Për rrjedhojë, institucioni i gjykatave popullore nuk mund të vihet në pikëpyetje në këtë kuadër. Shtetet palë gëzojnë liri të mjaftueshme në përzgjedhjen e mjeteve të përlllogaritura se sigurojnë që sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6. Detyra e Gjykatës është që të shqyrtojë nëse metoda e përdorur për këtë qëllim e ka çuar një çështje të

caktuar në rezultate që janë në përputhje me Konventën, ndërkohë që merr po ashtu parasysh rrethanat specifike, si dhe natyrën dhe kompleksitetin e çështjes. Thënë shkurt, Gjykata duhet të vlerësojë nëse procesi gjyqësor në tërësi ka qenë i rregullt (shih çështjen *Edwards k. Mbretërisë së Madhe*, 16 dhjetor 1992, § 34, Seritë A nr. 247-B, dhe *Stanford k. Mbretërisë së Madhe*, 23 shkurt 1994, § 24, Seritë A nr. 282-A).

85. Gjykata vëren se ajo ka pasur rastin më parë të shqyrtojë çështje lidhur me procedurën në gjykatat e krimeve të rënda. Për shembull, në çështjen *R. k. Belgjikës* (nr. 15957/90, vendim i Komisionit, datë 30 mars 1992, vendime dhe raporte (DR) 72) të Komisionit Evropian të Drejtave të Njeriut, konstatoi se megjithëse nuk ishin dhënë arsye për vendimin e fajësisë të marrë nga gjykata, Kryetari i Gjykatës së Krimeve të Rënda të paktën i kishte bërë pyetje anëtarëve të trupit gjykues paraprakisht lidhur me faktet e çështjes dhe i akuzuari kishte pasur mundësi të reagojë ndaj pyetjeve. Komisioni u shpreh se pikërisht këto pyetje, disa prej të cilave mund të bëheshin me kërkesë të akuzës ose të mbrojtjes, formonin kuadrin për vendimin në fjalë dhe përbënin kompensim të mjaftueshëm për shkurtësinë e përgjigjeve të trupit gjykues. Komisioni e rrëzoi padinë për vendimin si shprehimisht të pabazuar. Ai ndoqi të njëjtën qasje në çështjen *Zarouali k. Belgjikës* (nr. 20664/92, vendim i Komisionit, datë 29 qershor 1994, DR 78) dhe në çështjen *Planka k. Austrisë* (nr. 25852/94, vendim i Komisionit, datë 15 maj 1996).

86. Në vendimin për çështjen *Papon k. Francës* (cituar më lart), Gjykata vëren se prokurorisë dhe të akuzuarit i ishte dhënë mundësia e kundërshtimit të pyetjeve të bëra dhe mundësia për t'i kërkuar kryetarit t'i bënte një ose disa pyetje shtesë trupit gjykues. Duke vërejtur që trupi gjykues u ishte përgjigjur 768 pyetjeve të bëra nga kryetari i Gjykatës së Krimeve të Rënda, Gjykata u shpreh se ishte e mendimit që pyetjet formonin një kuadër ku mbështetej vendimi dhe se shkurtësia e përgjigjeve e justifikon mjaftueshmërisht mosdhënien e arsyeve për përgjigjet e anëtarëve të trupit gjykues. Kërkesa për mungesë të arsyetimit në vendimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda u rrëzuar si shprehimisht e pabazuar nga Gjykata.

87. Në çështjen *Bellerín Lagares k. Spanjës* ((ven.), nr. 31548/02, 4 nëntor 2003) Gjykata vërejti se vendimi objekt shqyrtimi kishte bashkëlidhur një procesverbal të shqyrtimeve të trupit gjykues, i cili përmbante një listë faktesh të pranuar prej trupit gjykues për marrjen e vendimit të fajësisë, një analizë ligjore e këtyre fakteve dhe një referencë për rrethanat e konstatuara se kishin pasur ndikim në nivelin e përgjegjshmërisë së kërkuesit, për qëllime të dënimit. Si rezultat, Gjykata u shpreh se vendimi në fjalë kishte arsye të mjaftueshme për qëllimin e nenit 6 § 1 të Konventës.

88. Në çështjen *Göktepe k. Belgjikës* (cituar më lart, § 28) Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 për shkak të refuzimit të Gjykatës së Krimeve të

Rënda për të bërë pyetje të veçanta për secilin të pandehur për të nxjerrë në pah rrethanat rënduese, duke i mohuar kështu mundësinë trupit gjykues për të vendosur për përgjegjësinë penale të kërkuesit. Në pikëpamjen e Gjykatës, fakti që një gjykatë nuk i ka marrë parasysh argumentet për një çështje jetike me pasoja kaq të rënda duhet të konsiderohet si jo në përputhje me parimin e të drejtës për të replikuar, e cila qëndron mu në zemër të nocionit të procesit të rregullt ligjor. Ky përfundim është posaçërisht i rëndësishëm për çështjen në fjalë, pasi anëtarët e trupit gjykues nuk u lejuan të jepnin arsye për vendimin e tyre (po aty., § 29).

89. Në vendimin për çështjen *Saric k. Denimarkës* (cituar më sipër) Gjykata konstatoi se mungesa e arsyeve në një vendim gjyqësor, lidhur me faktin që fajësia e kërkuesit ishte provuar nga një gjykatë tradicionale, në vetvete nuk ishte në kundërshtim me Konventën.

90. Rezulton nga jurisprudenca e cituar më sipër, se Konventa nuk u kërkon anëtarëve të trupave gjykues të këtyre gjykatave të japin arsye për vendimin e tyre dhe se neni 6 nuk e përjashton një të pandehur nga gjykimi prej një gjykate tradicionale, edhe kur nuk jepen arsyet e vendimit. Pavarësisht nga kjo, për plotësimin e kërkesave për gjykim të drejtë, i akuzuari, dhe në fakt i gjithë publiku, duhet të jenë në gjendja që ta kuptojnë vendimin e dhënë, pasi kjo është një garanci jetike kundër arbitraritetit. Siç është theksuar shpesh prej gjykatës, rregulli i së drejtës dhe shmangia e kompetencave arbitrare janë parime themelore të Konventës (shih, ndërmjet të tjerash, *mutatis mutandis*, *Roche k. Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 32555/96, § 116, GJEDNJ 2005-X). Në sferën gjyqësore, këto parime shërbejnë për forcimin e besimit të publikut për një sistem drejtësie objektiv dhe transparent, që përbën një ndër themelet e demokracisë (shih *Suominen k. Finlandës*, nr. 37801/97, § 37, 1 korrik 2003, dhe *Tatishvili k. Rusisë*, nr. 1509/02, § 58, GJEDNJ 2007-III).

91. Në proceset e përfunduara nga gjyqtarët profesionistë, qëndrimi i të akuzuarit për dënimin e tij rrjedh kryesisht nga arsyet e dhëna në vendimet gjyqësore. Në raste të tilla, gjykatat kombëtare duhet të thonë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat ata i bazojnë vendimet e tyre (shih *Hadjianastassiou k. Greqisë*, nr. 12945/87, 16 dhjetor 1992, § 33, Seritë A nr. 252). Vendimet e arsyetuara shërbejnë po ashtu për t'u demonstruar palëve se ata janë dëgjuar, duke kontribuar kështu në një pranim më të gjerë të vendimit prej tyre. Përveç kësaj, këto vendime i detyrojnë gjyqtarët që të mbështesin arsyetimin e tyre në argumente objektive dhe të ruajnë edhe të drejtën e mbrojtjes. Gjithsesi, niveli i detyrës për të dhënë arsye ndryshon në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet nën dritën e rrethanave të çështjes (shih *Ruiz Torija*, cituar më sipër, § 29). Ndërkohë që gjykatat nuk janë të detyruara t'i japin një përgjigje të detajuar çdo argumenti të ngritur (shih *Van de Hurk k. Holandës*, 19 prill 1994, § 61, Seritë A nr. 288), duhet të jetë e qartë nga vendimi i dhënë prej tyre që janë

trajtuar të gjithë elementët kryesorë të çështjes (shih *Boldea k. Rumanisë*, nr. 19997/02, § 30, GJEDNJ 2007-II).

92. Në rastet e gjykatave të krimeve të rënda që gjykojnë me një trup gjykues të përbërë nga gjyqtarë jo profesionistë, duhet të mbulohet çdo tipar i posaçëm procedural, për shkak se këtyre gjyqtarëve shpesh nuk u kërkohet, ose nuk u lejohej, të japin arsye të dënimeve të tyre personale (shih paragrafët 85-89 më sipër). Edhe në këto rrethana, neni 6 kërkon vlerësimin e faktit nëse ekzistojnë garanci të mjaftueshme për të shmangur çdo rrezik arbitrariteti dhe për t'i bërë të mundur të akuzuarit të kuptojë arsyet e dënimit kundër tij (shih paragrafin 90 më sipër). Garanci të tilla procedurale mund të përfshijnë, për shembull, drejtimet ose udhëzimet e ofruara nga gjyqtari kryesues për gjyqtarët jo profesionistë lidhur me çështjet ligjore që shtrohen, ose me provat a paraqitura (shih paragrafët 43 etj. më sipër), si dhe pyetje të sakta dhe të qarta që i bëhen trupit gjykues nga gjyqtari, duke formuar kështu një kuadër mbi bazën e të cilit jepet vendimi, ose duke e mbështetur mjaftueshmërisht faktin e mosdhënies së arsyeve me përgjigjet e trupit gjykues (shih çështjen *Papon*, cituar më sipër). Së fundmi, i duhet kushtuar vëmendje mundësive të apelit për të akuzuarin.

2. Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen në fjalë

93. Për çështjen në fjalë duhet të theksohet se në parashtrimet e tij para gjykatës kërkuesi u ankua për mungesë arsyesh në shpalljen e vendimit për fajësinë e tij dhe mungesës së apelimit kundër vendimit të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Siç është theksuar prej tij (shih paragrafin 87 më sipër), mungesa e një vendimi të arsyetuar nga një trup i tillë gjykues në vetvete nuk përbën shkelje të së drejtës së të akuzuarit për proces të rregullt ligjor. Duke gjykuar që përputhshmëria me kërkesat për proces të rregullt ligjor duhet të vlerësohen mbi bazën e të gjithë procesit në tërësi, dhe në kuadrin specifik të sistemit ligjor në diskutim në veçanti, detyra e Gjykatës në analizimin e mungesës së një vendimi të arsyetuar është të përcaktojë nëse, nën dritën e rrethanave të çështjes, procesi gjyqësor ka ofruar garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit dhe i ka bërë të mundur të akuzuarit të kuptojë arsyen pse ai u shpall. Duke e bërë këtë punë, Gjykata duhet të marrë parasysh se respektimi i një procesi të rregullt ligjor në shoqëritë demokratike duhet të sigurohet në nivelin më të lartë të mundshëm veçanërisht në rastet e dënimeve më të rënda (shih *Salduz k. Turqisë* [GC], nr. 36391/02, § 54, GJEDNJ 2008-...).

94. Në çështjen në fjalë kërkuesi u akuzua për vrasjen e një ministri nderi dhe për tentativë për vrasje të partneres së këtij të fundit. Pavarësisht nga kjo, as aktakuza dhe as pyetjet që iu drejtuan trupit gjykues nuk përmbajnë informacion të mjaftueshëm lidhur me përfshirjen e kërkuesit në kryerjen e veprave për të cilat ai akuzohej.

95. Duke pasur parasysh, së pari, aktakuzën e përpiluar prej prokurorit kryesor, Kodi i Procedurë Penale parashikon që në të duhet të jepet natyra e veprës që formon bazën e akuzës, si dhe çdo rrethanë që mund të çojë në ngritjen ose uljen e dënimit dhe se pretendja e akuzës duhet të lexohet në fillim të procesit (shih paragrafin 26 më sipër). Në mënyrë të qartë, i akuzuari mund të kundërshtojë aktakuzën nëpërmjet një deklarate të avokatit të tij, por praktikisht deklarata ka efekt të kufizuar për shkak se ajo bëhet në fillim të seancës, madje dhe përpara fillimit real të procesit të gjyimit, dhe duhet të shërbejë si bazë për bindjen personale të trupit gjykues. Si rezultat, vlera e një deklarate të tillë për një të pandehur të dënuar për të kuptuar se pse trupi gjykues ka marrë vendim fajësie për të është e kufizuar. Në çështjen në fjalë, një analizë e aktakuzës së datës 12 gusht 2003 tregon se ajo përmban një përshkrim të detajuar të hetimeve policore edhe hetimore dhe shumë deklarata kontradiktore të bëra nga të akuzuarit e tjerë. Megjithatë në të përmenden të gjitha veprat penale për të cilat akuzohet i pandehuri, aktakuza nuk jep qartazi provat që prokuroria mund të përdorë kundër tij.

96. Për më tepër, për të qenë në gjendje të marrë një vendim, trupit gjykues iu desh t'i përgjigjej tridhjetë e dy pyetjeve të bëra nga Kryetari i Gjykatës së Krimeve të Rënda. Kërkuesi, i cili paraqitej në gjykatë së bashku me shtatë të akuzuarit e tjerë, prekej vetëm nga katër nga këto pyetje, secila prej të cilave mori përgjigje afirmative nga trupi gjykues (shih paragrafin 15 më sipër). Pyetjet, ishin të shkurtra dhe identike për të gjithë të akuzuarit, dhe nuk i referoheshin ndonjë rrethane të qartë dhe specifike që mund t'i kishte bërë të mundur kërkuesit të kuptonte arsyet pse ai u deklarua fajtor. Në këtë aspekt çështja në fjalë është e ndryshme nga çështja *Papon* (cituar më sipër), në të cilën Gjykata e Krimeve të Rënda iu referua përgjigjeve të trupit gjykues për secilën nga 768 pyetjeve të bëra nga kryetari i gjykatës si dhe përshkrimit të fakteve të pranuar dhe parashikimeve të neneve të Kodit Penal (të zbatuara, shih paragrafin 86 më sipër).

97. Rezulton që, edhe në lidhje me aktakuzën, pyetjet e bëra në çështjen aktuale nuk i bënë të mundur kërkuesit të identifikonte se cilat nga provat dhe nga rrethanat faktike të diskutuara gjatë procesit të gjyimit e kishin shtyrë përfundimisht trupin gjykues t'i përgjigjeshin me “po” katërt pyetjeve të lidhura me të. Pra, kërkuesi nuk kishte mundësi, për shembull, të bënte një dallim të qartë ndërmjet përfshirjes së të akuzuarve të tjerë në kryerjen e veprës penale; të ishte i sigurt për perceptimin e trupit gjykues për rolin e tij specifik në lidhje me të akuzuarit e tjerë; të kuptonte pse vepra ishte klasifikuar si vrasje me paramendim (*assassinat*) dhe jo si vrasje (*meurtre*); të përcaktonte se cilët faktorë e kishin shtyrë trupin gjykues të arrinte në përfundimin se përfshirja e dy nga të akuzuarit e tjerë në aktet e pretenduara ishte e kufizuar, duke iu dhënë atyre një dënim më të ulët; ose të kuptonte pse në rastin e tij u mor parasysh faktori rëndues i vrasjes me

paramendim për veprën e tentativës për vrasje për partneren e A.C.-së. Kjo mangësi bëhet edhe më shumë problematike për shkak të faktit që çështja është komplekse si nga aspekti faktik dhe nga aspekti ligjor dhe se gjykimi zgjati për më shumë se dy muaj (më saktësisht nga data 17 tetor 2003 deri më 7 janar 2004) periudhë gjatë së cilës dhanë provat e tyre shumë dëshmitarë dhe ekspertë.

98. Në këtë pikë, duhet të theksohet se bërja e pyetjeve precize për trupin gjykues përbën kërkesë të domosdoshme që kërkuesi të kuptojë çdo vendim fajësie të marrë kundër tij. Për më tepër, përderisa çështja përfshin më shumë se një të pandehur, pyetjet duhet të ishin të lidhura sa më shumë të ishte e mundur me secilin nga të pandehurit.

99. Së fundmi, duhet të theksohet se sistemi belg nuk parashikon në asnjë dispozitë një procedurë të zakonshme apeli kundër vendime të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Apeli në Gjykatën e Kasacionit lidhet vetëm me çështje të ligjshmërisë e, duke qenë kështu, nuk i jep të akuzuarit qartësimin e nevojshëm për arsyet e dënimit të tij. Dispozita e nenit 352 të KPP-së, i cili parashikon se në rast se trupi gjykues ka bërë një gabim substantiv, Gjykata e Krimeve të Rënda duhet të pezullojë procesin dhe ta shtyjë çështjen deri në një seancë të mëvonshme shqyrtimi nga një trup i ri gjykues (shih paragrafin 31 më sipër), realisht përdoret shumë rrallë.

100. Në përfundim, kërkuesit nuk i janë dhënë garanci të mjaftueshme për t'i bërë të mundur të kuptojë arsyet pse është shpallur fajtor. Për shkak se procesi nuk ishte i rregullt, ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

III. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 3 (d) TË KONVENTËS

101. Kërkuesi pretendon se nuk ka qenë në gjendje në asnjë fazë së procesit gjyqësor t'i drejtojë pyetje dëshmitarit anonim ose të sigurojë marrjen e tij në pyetje. Ai pretendon shkelje të nenit 6 § 3 (d), i cili parashikon:

“6. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: ...

(d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; ...”

102. Gjykata vëren se kjo ankesë është e lidhur ngushtë me faktet që e çuan Gjykatën të shprehej për shkelje të nenit 6 § 1. Në mungesë të çdo arsyetimi të vendimit, është e pamundur të thuhet me siguri nëse dënimi i kërkuesit është bazuar në informacionin e dhënë nga dëshmitari anonim, ose jo. Në këto rrethana, Gjykata është e mendimit se nuk është e nevojshme të shqyrtojë veçmas ankesën për shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

103. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një kompensim i pjesshëm, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

104. Siç ka bërë përpara Dhomës, ankimuese ka kërkuar dëmshpërblim prej 100,000 eurosh për dëmin moral.

105. Qeveria parashtroi se shumë prej 4,000 eurosh e përcaktuar nga Dhoma nën këtë zë në vendimin e saj, datë 13 janar 2009 ishte “shumë e arsyeshme”.

106. Dhoma e Madhe, duke e bërë vlerësimin e saj mbi një bazë të drejtë, i jep kërkuarit EUR 4,000 për dëmet morale.

107. Gjykata vëren më tej se ligji, datë 1 prill 2007, e ka ndryshuar Kodin e Procedurës Penale duke u lejuar kërkuarve të kërkojnë rihapjen e procesit gjyqësor në rastet kur Gjykata konstaton shkelje për çështjet e tyre (shih paragrafët 38 etj. më sipër dhe, *mutatis mutandis*, *Öcalan k. Turqisë* [GC], nr. 46221/99, ECHR 2005-IV).

B. Kostot dhe shpenzimet

108. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet, Gjykata vëren se Dhoma vendosi t’i japë kërkuarit 8,173.22 euro, shumë e cila nuk u kontestua nga Qeveria. Në lidhje me proceset para Dhomës së Madhe, kërkuarit i jepen 1,755.20 euro për ndihmë ligjore nga Këshilli i Evropës. Si rezultat, Gjykata e konfirmon shumën e 8,173.22 eurosh të dhëna nga Dhoma.

C. Interesi i munguar

109. Gjykata e mendon të arsyeshme që niveli i interesit të bazohet në nivelin bazë të huasë së Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilin duhet të shtohen tre pikë përqindje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT

1. *vendos* se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës;
2. *vendos* që nuk është e nevojshme që të shqyrtohet veçmas ankesa për shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe ankesa për shkelje të nenit 3 (d) të Konventës për mos marrjen në pyetje të dëshmitarit anonim;
3. *vendos*
 - (a) që shteti i paditur i paguan kërkuarit, brenda tre muajsh, shumat e mëposhtme:
 - (i) 4,000 euro (katër mijë euro), plus çdo tatim të aplikueshëm mbi këtë shumë në lidhje me dëmin moral;
 - (ii) 8,173.22 euro (tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre euro dhe njëzet e dy cent), plus çdo tatim të aplikueshëm mbi të në lidhje me kostot dhe shpenzimet për procesin;
 - (b) që nga kalimi i afatit kohor prej tre muajsh të përcaktuar më sipër deri në shlyerjen e plotë do të paguhet interes i barabartë me nivelin bazë të huasë të Bankës Qendrore Evropiane, plus tre pikë përqindje;
4. *rrëzon* pjesën tjetër të padisë së kërkuarit për dëmshpërblim të drejtë.

Bërë në anglisht dhe në frëngjisht dhe marrë në një seancë me dyer të hapura në Ndërtesën e të Drejtave të Njeriut (thee Human Rights Building), në Strasburg, më 16 nëntor 2010.

Michael O'Boyle

Jean-Paul Costa

Zëvendës Regjistrues

President

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe me Rregullin 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, opinioni i pakicës i Gjyqtarit Jebens i bashkëlidhet këtij vendimi.

Opinionet më vete nuk janë përkthyer, por janë në anglisht dhe/ose frëngjisht, në variant(et) e gjuhës zyrtare të vendimit, që mund t'i gjeni në bazën e të dhënave HUDOC të jurisprudencës së Gjykatës.

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2012.

Gjuhët zyrtare të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë anglisht dhe frëngjisht. Ky përkthim u krye me mbështetje të Fondit të Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës (www.coe.int/humanrightstrustfund). Ai nuk është detyrues për Gjykatën, e cila nuk mban përgjegjësi për cilësinë e tij. Ai mund të shkarkohet nga HUDOC, baza e të dhënave të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (<http://hudoc.echr.coe.int>) ose nga çdo bazë tjetër të dhënash me të cilën Gjykata e ndan atë. Ai mund të riprodhohet për qëllime jo-komerciale, me kusht që të citohet titulli i plotë i çështjes, së bashku me të dhënat e mësipërme për të drejtën e autorit dhe referencën për Fondin e Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut. Për përdorimin e çdo pjese të këtij përkthimi për qëllime komerciale, ju lutemi të kontaktoni në adresën publishing@echr.coe.int.

© Council of Europe/European Court of Human Rights, 2012.

The official languages of the European Court of Human Rights are English and French. This translation was commissioned with the support of the Human Rights Trust Fund of the Council of Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). It does not bind the Court, nor does the Court take any responsibility for the quality thereof. It may be downloaded from the HUDOC case-law database of the European Court of Human Rights (www.coe.int/humanrightstrustfund) or from any other database with which the Court has shared it. It may be reproduced for non-commercial purposes on condition that the full title of the case is cited, together with the above copyright indication and reference to the Human Rights Trust Fund. If it is intended to use any part of this translation for commercial purposes, please contact publishing@echr.coe.int.

© Conseil de l'Europe/Cour européenne des droits de l'homme, 2012.

Les langues officielles de la Cour européenne des droits de l'homme sont le français et l'anglais. La présente traduction a été effectuée avec le soutien du Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme du Conseil de l'Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). Elle ne lie pas la Cour, et celle-ci décline toute responsabilité quant à sa qualité. Elle peut être téléchargée à partir de HUDOC, la base de jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme (www.coe.int/humanrightstrustfund), ou de toute autre base de données à laquelle HUDOC l'a communiquée. Elle peut être reproduite à des fins non commerciales, sous réserve que le titre de l'affaire soit cité en entier et s'accompagne de l'indication de copyright ci-dessus ainsi que de la référence au Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme. Toute personne souhaitant se servir de tout ou partie de la présente traduction à des fins commerciales est invitée à le signaler à l'adresse suivante: publishing@echr.coe.int.